FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.140 29 dhjetor 2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.65, datë 13.11.2006	Për mosmiratimin e raportit të Kryetarit të Këshillit për Legjislacionin për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Kuvendit	5529
Vendim i KM nr.803, datë 12.12.2006	Për lejimin e kalimit transit të disa trupave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë……	5529
Vendim i KM nr.819, datë 6.12.2006	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, bashkisë Berat të qarkut të Beratit……	5530
Vendim i KM nr.833, datë 13.12.2006	Për dhënie fondi ndihmë partisë shqiptare “Atdheu”……	5531
Vendim i KM nr.838, datë 13.12.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”, të ndryshuar……	5531
Vendim i KM nr.840, datë 13.12.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.198, datë 5.4.2006 të Këshllit të Ministrave “Për pranimet në universitetet dhe shkollat e larta, për vitin akademik 2006-2007, në sistemin me kohë të plotë dhe për caktimin e tarifës së shkollimit në sistemin me kohë të plotë” të ndryshuar……	5532
Vendim i KM nr.841, datë 13.12.2006	Për pagesën e anëtarëve, në përbërje të komisioneve për vlerësimin, miratimin dhe certifikimin e teksteve shkollore dhe të materialeve të tjera ndihmëse, në sistemin arsimor parauniversitar…… ……	5532

Vendim i GJK nr.29, datë 21.12.2006	Me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore (Bashkia Tiranë) dhe pushtetit qendror (Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Policia e Ndërtimit)……	5533
	Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës dhe Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit…….	5549
Udhëzim i KQZ nr.11, datë 5.12.2006	Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të qendrës së votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore……	5551
Udhëzim i KQZ nr.12, datë 15.12.2006	Për përcaktimin e rregullave për deklarimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2007……..	5554
Udhëzim i KQZ nr.13, datë 19.12.2006	Për caktimin dhe përgatitjen e vendit të numërimit të votave, dhe mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit……	5558

VENDIM
Nr.65, datë 13.11.2006

PËR MOSMIRATIMIN E RAPORTIT TË KRYETARIT TË KËSHILLIT PËR LEGJISLACIONIN PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË KUVENDIT

Në mbështetje të neneve 75 dhe 78 të Kushtetutës, si dhe të nenit 114 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Mosmiratimin e raportit të paraqitur nga Kryetari i Këshillit për Legjislacionin dhe ndërprerjen e procedurës për shkarkimin nga detyra të Kryetares së Kuvendit, zonjës Jozefina TOPALLI (ÇOBA).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Fatos Beja

VENDIM
Nr.803, datë 12.12.2006

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.93763, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të disa trupave ushtarake sllovene, të përbëra prej 36 (tridhjetë e gjashtë) trupash dhe 18 (tetëmbëdhjetë) mjetesh, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 13 dhjetor 2006.

Nga këto, 26 (njëzet e gjashtë) trupa, 1 (një) autobus dhe 2 (dy) makina të Policisë Ushtarake do të rikthehen në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë do të jetë pika e kalimit të kufirit në Qafë-Thanë. Pikat e daljes do të jenë Porti i Durrësit dhe pika e kalimit të kufirit në Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në "Marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre", ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Trupat sllovene, gjatë itinerarit të lëvizjes, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.819, datë 6.12.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË I TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, BASHKISË BERAT TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, bashkisë Berat të qarkut të Beratit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Berat, miratuar me vendimin nr.326, datë 21.5.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Beratit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit nëFletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

BASHKIA BERAT
LIDHJE 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-31	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
35,39-48	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
49-57,1349	Prona që përdoren për mbrojtjen civile dhe strehim	Në pronësi
58,59,60	Varrezat publike	Në pronësi
61, 62, 63, 64-73,1409-2798, 2802-3009	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
74-1240	Infrastrukturë (troje)	Në përdorim
1255	Prona që përdoren në fushën e administratës	Në pronësi
1275,1278,1279,1280,1350-1355,1357,1358,1405,1406	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
1311-1335,1344,1345,1347	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve kulturore sportive	Në pronësi
1366-1373	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën sociale	Në pronësi

3010-3013	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

VENDIM
Nr.833, datë 13.12.2006

PËR DHËNIE FONDI NDIHMË PARTISË SHQIPTARE "ATDHEU"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë shqiptare "Atdheu" t'i jepet një fond prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.838, datë 13.12.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.231, DATË 11.5.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL DHE PERIUDHËN E PROVËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 17 e vendimit nr.231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"17. Pikët maksimale të mundshme janë:

a) 70 pikë në rezultatin e testimit;

b) 10 pikë për përvojën në punë të kandidatit dhe kualifikimet afatshkurtra;

c) 12 pikë për diplomën master;

ç) 8 pikë për aftësitë e veçanta personale;

d) kandidatët me gradë shkencore "Doktor i shkencave" vlerësohen me pikët maksimale të testimit me gojë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.840, datë 13.12.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.198, DATË 5.4.2006 TË KËSHLLIT TË MINISTRAVE "PËR PRANIMET NË UNIVERSITETET DHE SHKOLLAT E LARTA, PËR VITIN AKADEMIK 2006-2007, NË SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË DHE

PËR CAKTIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.198, datë 5.4.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në pikën 7, në fjalinë e dytë, pas fjalëve "…degë e dytë…" të shtohen "…të jetë e diferencuar për degë të ndryshme dhe…".

b) Në pikën 10.2, në fund të paragrafit, të shtohen fjalët "…sipas pikës 9, të këtij vendimi.".

c) Në pikën 13, fjalët "…të barabartë me tarifën e kuotave kryesore, duke filluar nga viti akademik 2006-2007…. " zëvendësohen me "…të njëjtë me tarifën për degë të dytë, në të gjitha vitet e studimit…".

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.841, datë 13.12.2006

PËR PAGESËN E ANËTARËVE, NË PËRBËRJE TË KOMISIONEVE PËR VLERËSIMIN, MIRATIMIN DHE CERTIFIKIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE DHE TË MATERIALEVE TË TJERA NDIHMËSE, NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 52 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët, në përbërje të bordit të miratimit të teksteve shkollore, për periudhën e veprimtarisë së bordit, të paguhen me 30 për qind të pagës mujore të "Doktorit të Shkencave", në universitetet dhe shkollat e larta, ndërsa kryetari i bordit me 30 për qind të pagës mujore, të "Profesorit", në universitetet dhe shkollat e larta.

2. Vlerësuesit e teksteve, të aktivizuar për kryerjen e procesit të vlerësimit, miratimit dhe certifikimit të teksteve shkollore, të paguhen, përkatësishst, sipas punës (për çdo tekst), po jo më shumë se 3 persona për secilën kategori vlerësimi:

a) Për vlerësim shkencor 4 000 lekë;
b) Për vlerësim gjuhësor 3 000 lekë;
c) Për vlerësimin e metodologjisë 3 000 lekë;
ç) Për vlerësim dizanji 1 500 lekë;
d) Për vlerësim krahasues të njëjtësisë dhe ndryshimeve 1 000 lekë.

3. Specialistët a punonjësit, e thirrur pranë bordeve, komisioneve apo grupeve të punës, me

kërkesë të bordit të miratimit të teksteve, për mbështetje teknike dhe veprime sekretarie, në periudhat e miratimit të teksteve, të paguhen, sipas normave, për punën e kryer jashtë kohës normale të punës.

4. Masa e pagesës për të gjithë personat e aktivizuar në këtë proces miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe përballohet nga buxheti i shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 29, datë 21.12.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“ “
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“ “
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“ “
Kujtim Puto	Anëtar	i	“ “
Vjollca Meçaj	Anëtare	e	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 2.5.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.25 Akti që i përket:

KËRKUES: BASHKIA E TIRANËS, përfaqësuar nga Natasha Kondi e Migena Vishko, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Idar Bistri, me autorizim.

2. KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Marin Biçoku, me autorizim.

3.MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, përfaqësuar nga Enkelejd Alibej, Andi Toma e Marin Biçoku, me autorizim.

4. POLICIA NDËRTIMORE, përfaqësuar nga Gentian Nebiaj, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore (Bashkia Tiranë) dhe pushtetit qendror (Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Policia e Ndërtimit).

2. Me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes kompetencave, shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, si dhe shfuqizimin e:

a) neneve 9, paragrafi i parafundit, 10, 19, 21, 54 (fjalia “*apo Policia e Ndërtimit”*), 75/2 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”,

b) neneve 2, (fjalia “Policia e Ndërtimit varet nga Ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit”), 3/3 (fjalia “të marrë vendim për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm”) dhe nenin 6 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”.

3. Interpretimin përfundimtar të nenit 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi, në referencë të neneve 124/1, 131, shkronja "ç" dhe 134/1, shkronja "e", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 54, 56/2 dhe 71 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", ka iniciuar një gjykim të karakterit kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, duke parashtruar pretendimet e tij në këto drejtime kryesore:

- Sipas parimeve të decentralizmit të pushtetit, të autonomisë vendore, të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit, të parashikuar në nenin 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.8548, datë 11.11.1999, të cilët kanë gjetur zbatim në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", bashkitë dhe komunat ushtrojnë funksionet e veta dhe janë përgjegjëse në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Pavarësisht këtyre standardeve bashkëkohore, planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe kontrolli mbi territorin, megjithëse nga 1 janari i vitit 2002 janë *"funksione të veta"* të bashkisë e komunës, sipas disa ligjeve të veçanta vazhdojnë të ushtrohen në mënyrë të centralizuar nga pushteti qendror.

- Disa prej dispozitave të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" dhe të ligjit nr.8408, datë 25.09.1998 "Për Policinë e Ndërtimit" cenojnë parimin e decentralizmit të pushtetit dhe të autonomisë vendore, i atribuojnë pushtetit qendror çështje të administrimit të ndërtimeve dhe territorit, si dhe uzurpojnë vendimmarrjen lokale. Në zbatim të këtyre ligjeve me përmbajtje antikushtetuese, janë nxjerrë disa akte juridike, të cilat kanë bllokuar veprimtarinë e Bashkisë së Tiranës dhe të organit të saj, KRRT-së, si edhe kanë shërbyer si bazë për lindjen e mosmarrëveshjeve të kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror në fushën e planifikimit, menaxhimit urban dhe të kontrollit mbi territorin.

Kërkuesi, me qëllim eliminimin e shkakut të mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushteteve, ka parashtruar argumentet për papajtueshmërinë e dispozitave të sipërcituara me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kartën Europiane ë Autonomisë Vendore, të cilat përqendrohen në këto drejtime kryesore:

- Paragrafi i parafundit i nenit 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", sipas të cilit KRRTRSH-ja miraton dhënien e lejes së ndërtimit për objekte të rëndësishme në qendrat e qyteteve, cenon parimin e autonomisë vendore dhe të subsidiaritetit.

- Neni 10 i ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" është në kundërshtim me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, sepse i jep të drejtë KRRTRSH-së të shfuqizojë vendimet e KRRT-së. KRRTRSH-ja nuk është organ hierarkik i KRRT-së, për arsye se këto organe i përkasin pushteteve të ndryshme. Ndërhyrja e këtij organi nuk është e justifikueshme, përderisa kontrolli administrativ për ligjshmërinë e aktit realizohet nëpërmjet të drejtës së prefektit për pezullim, si dhe vendimmarjes së organeve të pushtetit gjyqësor.

- Formulimi i nenit 19 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", që përcakton përbërjen dhe funksionimin e KRRT-së, si autoriteti vendimmarrës i pushtetit vendor me një shumicë prej afro 2/3 nga pushteti qendror, legjitimon ndërhyrjen e pushtetit qendror në planifikimin urban, duke i nxjerrë organet e qeverisjes vendore jashtë kompetencës kushtetuese.

- Në funksion të papajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të nenit 19, jepen argumente për nenin 21 të këtij ligji, duke u bazuar dhe në antikushtetutshmërinë e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.4, datë 13.12.2005 "Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën".

- Nenet 54, 75/2 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", si dhe nenet 2, 3/3 dhe 6, të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit", që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet bashkisë dhe policisë ndërtimore, bien ndesh me parimin e autonomisë vendore dhe të proporcionalitetit të përcaktuar nga Karta Europiane e Autonomisë Vendore. Funksioni parësor i pushtetit vendor është administrimi i territorit nën juridiksion, ndryshe nga ligji që vendos policinë ndërtimore nën varësinë e pushtetit qendror, duke e pajisur me kompetenca ekzekutive dhe urdhërdhënëse për çështje të pushtetit vendor.

Përfaqësuesi i subjekteve të interesuara kërkoi rrëzimin e kërkesës së paraqitur, duke argumentuar në këto drejtime kryesore:

- *Kërkuesi nuk ka legjitimitet formal dhe procedural, sepse:*

- Kërkesa duhet të tregojë Kryetarin e Bashkisë dhe jo Bashkinë si kërkues në kuptim të nenit

134 pika 1 shkronja “e” të Kushtetutës.

- Kryetari i Bashkisë nuk ka tagër përfaqësimi, sepse sipas nenit 109/1 të Kushtetutës, organe përfaqësuese janë këshillat e bashkisë dhe të komunës. Neni 32 shkronja “h”, i ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, parashikon se këshilli bashkiak është organi kompetent që vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet.

- Konflikti duke u argumentuar *in abstracto* dhe jo *in concreto*, nuk i krijon mundësitë Gjykatës Kushtetuese të shqyrtojë mosmarrëveshjen konkrete që përbën bazën e konfliktit të kompetencave.

- Mosmarrëveshja e kompetencave, si e prezumuar dhe jo reale midis KRRT-së, nga njëra anë, dhe KRRTRSH-së e Policisë Ndërtimore, nga ana tjetër, është ngritur nga kërkuesi në mbrojtje të pushtetit vendor dhe jo të KRRT-së. Ai nuk ka tagër përfaqësimi nga KRRT-ja, për më tepër që konflikti nuk është ngritur nga vetë KRRT-ja.

- Kërkesa nuk i referohet afatit gjashtëmujor që parashikon neni 55 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, sepse ajo nuk referon te ndonjë akt nënligjor apo administrativ të nxjerrë nga ndonjë organ në mosmarrëveshjen konkrete.

Për kërkesën e dytë të paraqitur që ka të bëjë me mënjanimin e shkakut të mosmarrëveshjes së kompetencave, nëpërmjet shpalljes së papajtueshmërisë të dispozitave ligjore me Kushtetutën dhe me marrëveshjen ndërkombëtare, subjekti i interesuar ka pretenduar:

- *Kërkuesi nuk ka legjitimitet*. Neni 134/2 i Kushtetutës kërkon justifikimin e interesit nga Kryetari i Bashkisë si subjekt që legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin e ligjit. Për çështje të vetëqeverisjes vendore, të drejtën apo interesin për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese e ka organi përfaqësues, këshilli bashkiak apo ai i komunës.

- *Kërkesa është e parashkruar*. Në bazë të nenit 50 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kërkesa për shfuqizimin e ligjit mund të paraqitet brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e tij.

- *Çështja është gjë e gjykuar*. Vendimi nr.2, datë 25.1.1999 i Gjykatës Kushtetuese, e ka trajtuar kushtetutshmërinë e disa prej dispozitave, objekt shqyrtimi. Miratimi i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore nuk përbën një argument të ri, sepse autoritetet shqiptare e kanë nënshkruar atë më datë 27.5.1998, pra rreth tetë muaj para vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Bashkia e Tiranës, nëpërmjet Kryetarit të saj në cilësinë e organit të qeverisjes vendore, i është drejtuar kësaj Gjykate, me pretendimin se ndërmjet qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror kanë lindur mosmarrëveshje në ushtrimin e kompetencave të tyre kushtetuese. Si shkak kryesor që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjeve të kompetencave ndërmjet këtyre pushteteve, kërkuesi ka identifikuar ushtrimin nga disa organe të pushtetit qendror (Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ministra e Punëve Publike, Transportit dhe e Telekomunikacionit, si dhe Policia Ndërtimore) të kompetencave të organeve të qeverisjes vendore në fushën e planifikimit e të menaxhimit urban, si dhe të kontrollit mbi territorin. Ushtrimi i kompetencave në këto fusha, duke iu referuar disa dispozitave të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” si dhe të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, është materializuar me nxjerrjen e disa akteve nënligjore, si akti normativ me fuqinë e ligjit i Këshillit të Ministrave nr.4, datë 13.12.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, që i njeh të drejtën prefektit të mbledhë Këshillin e Rregullimit të Territorit pranë bashkisë, vendimi i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë Tiranë nr.309, datë 5.7.2004, si dhe vendimi i Policisë Ndërtimore për prishjen e një vepre të rëndësishme publike të qytetit të Tiranës. Nxjerrja e këtyre akteve me natyre juridike, bazuar në ligjet e sipërcituara, ka bllokuar veprimtarinë e Bashkisë Tiranë dhe të KRRT-së si organ i specializuar për

urbanistikën në pushtetin vendor dhe ka shërbyer si bazë për lindjen e mosmarrëveshjeve të kompetencave midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore në fushën e planifikimit urban dhe kontrollit mbi territorin.

Meqenëse, sipas kërkuesit, shkaku kryesor për lindjen e kësaj mosmarrëveshje është përmbajtja antikushtetuese e dispozitave ligjore të sipërcituara, ku janë bazuar organet e pushtetit qendror për nxjerrjen e akteve përkatëse, atëherë i vetmi instrument për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore është shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese me qëllim që kjo të përcaktojë organin kompetent për çështjet konkrete, duke shpallur pajtueshmërinë ose jo të këtyre dispozitave me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore.

Për të realizuar shqyrtimin gjyqësor kushtetues nga ku do të synohet nxjerrja e konkluzioneve përkatëse për këtë çështje, Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme të analizojë në aspektin e doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, kuptimin e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushteteve, si edhe ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor, përcaktimin e rrethit të subjekteve që kanë të drejtë të iniciojnë procesin kushtetues të kësaj natyre dhe të vendosë për zgjidhjen e çështjes konkrete nëpërmjet interpretimit përfundimtar të nenit 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në bazë të nenit 131 shkronja “ç” të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror e qeverisjes vendore. Çështje të kësaj natyre ngrihen nga organi kushtetues kompetent duke i kërkuar Gjykatës Kushtetuese të deklarojë përfundimisht organin, të cilit i takon të ushtrojë vullnetin e vet në sferën e caktuar të veprimtarisë shtetërore, dhe të përcaktojë gamën e kompetencave të tij .

Dispozita e shkronjës “ç” të nenit 131 të Kushtetutës përfshin mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes së pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror-qeverisje vendore). Veç këtyre, mbështetur në jurisprudencën kushtetuese, kjo dispozitë përfshin edhe një gamë tjetër mosmarrëveshjesh, siç janë ato që mund të lindin midis organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike, në këtë ose atë pushtet, siç janë Presidenti, Gjykata Kushtetuese, prokuroria dhe organe të tjera kushtetuese.

Ndarja e pushteteve në thelb nuk është gjë tjetër veçse ndarje kompetencash. Kompetenca është tagra që i jepet juridikisht një organi ose një pushteti për të vendosur mbi çështje të caktuara. Që një mosmarrëveshje kompetence të përfshihet në juridiksionin kushtetues duhet që ajo të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme dhe që secili prej tyre të kërkojë veçmas tjetrit të materializojë vullnetin e pushtetit, të cilit i përket, duke nxjerrë akte që ai çmon se i takojnë sferës së vet të kompetencave.

Duke iu referuar doktrinës dhe jurisprudencës kushtetuese, Gjykata Kushtetuese vlerëson se mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit *"normativ"* kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit *"individual",* kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse të zbatimit të ligjit konkret.

Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjesh të ndryshëm dy institucioneve, si edhe kur ligji parashikon kompetencën, por nuk ka saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto* dhe duke abstraguar nga rasti konkret. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe, mbi këtë bazë, ka nxjerrë aktin individual të zbatimit.

Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit, me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit. Pavarësisht nga shprehja ose jo e kundërshtimeve për përkatësinë e pushtetit, mund të konsiderohet se konflikti është i pranueshëm për t’u gjykuar edhe në rast se nga ushtrimi abuziv i pushtetit pakësohen ose pengohen ushtrimi i kompetencave që Kushtetuta ia atribuon subjektit ankues.

Konflikti ndërmjet ligjeve që ka lindur për çështje përkatësie kompetencash midis organesh kushtetuese përbën çështje kushtetuese, ndryshe nga rastet e tjera të kolizionit ligjor, për të cilët gjykata e zakonshme është kompetente të vendosë se cili nga ligjet është i zbatueshëm për çështjen në shqyrtim para saj. Ky është aspekti dallues që paraqet çështja e mosmarrëveshjeve të kompetencës si prerogativë e Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht nëse mosmarrëveshja përkatëse ka lindur në bazë të ligjit si akt normativ apo të aktit të zbatimit të tij si akt individual i organit përkatës.

Duke shtjelluar dispozitën e nenit 131 shkronja "ç" të Kushtetutës, ligjvënësi në nenin 54 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" specifikon se "*Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim këto konflikte kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete dhe, sipas rastit, kanë nxjerrë aktet për rregullimin e saj, ose kur subjektet nuk e kanë konsideruar veten kompetente të vendosin në raste të veçanta."* Para së gjithash, kjo dispozitë bën fjalë për mosmarrëveshje ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme, objekt i së cilës është përkatësia e një kompetence, si edhe për organin që ankohet se i është cenuar sfera e kompetencës dhe që, për këtë arsye, i drejtohet Gjykatës Kushtetuese të deklarojë organin të cilit i përket kompetenca në fjalë.

Ligji organik për Gjykatën Kushtetuese formulon orientime të përgjithshme për organin që ka të drejtën të iniciojë gjykime të këtij lloji, por ai nuk specifikon konkretisht se cilët janë këto organe. Sipas nenit 54 pika 3 të këtij ligji, kërkesa para Gjykatës Kushtetuese ngrihet nga *subjektet në konflikt* ose nga *subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti*. Pavarësisht nga karakteri objektiv apo subjektiv i shkakut që lind mosmarrëveshjen, Gjykata Kushtetuese vendos, sipas nenit 56 të ligjit të sipërpërmendur, se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete, për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, ajo shqyrton gjithashtu edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet pikësëpari në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa i takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe eliminuar dhe shkakun vendimtar që e ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes.

Nisur nga sa u parashtrua më sipër, nxirret konkluzioni se çdo organ pushteti legjitimohet të bëjë kërkesë para Gjykatës Kushtetuese kur ai pretendon se ndodhet para një konflikti kompetence, i cili mund të ketë lindur për shkak të ligjit ose të një veprimtarie faktike. Përcaktuese është që sfera e kompetencave e organeve apo subjekteve të konfliktuara duhet të jetë e përkufizuar nga norma kushtetuese.

Nga kjo analizë, Gjykata Kushtetuese konkludon se Bashkia e Tiranës, nëpërmjet Kryetarit të saj, si organ ekzekutiv i qeverisjes vendore dhe një ndër subjektet e parashikuara nga neni 134/1 shkronja "e" të Kushtetutës, por, për më tepër, si "*subjekt në konflikt"*, që pretendon për ekzistencën e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, duke iu referuar parimit të decentralizmit të pushtetit dhe të autonomisë vendore, legjitimohet në aspektin kushtetues për të ngritur një çështje të kësaj natyre. Edhe në aspektin e legjitimimit formal e procedural është Kryetari i Bashkisë, i cili mban edhe pozicionin e Kryetarit të KRRT-së, që sipas ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ushtron të gjitha kompetencat që ligji i ka njohur komunës ose bashkisë në fushën e planifikimit urban.[*]

Përpara shqyrtimit të hollësishëm të pretendimeve të kërkuesit, Gjykata Kushtetuese çmon të domosdoshme të analizojë dhe t'u japë përgjigje disa pretendimeve të parashtruar nga subjekti i interesuar dhe që kanë të bëjnë me *parashkrimin e kërkesës* dhe me *ekzistencën e gjësë së gjykuar*.

Është i pathemeltë pretendimi i subjektit të interesuar për ta konsideruar çështjen e ngritur nga kërkuesi si të parashkruar duke paraqitur si argument periudhën kohore që ndan lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror e qeverisjes vendore dhe kohës së hyrjes në fuqi të ligjit burim konflikti. Afati trevjeçar i parashkrimit për të kërkuar kontrollin kushtetues të një ligji, që parashikohet në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH", zbatohet në rastet kur subjektet përkatëse kanë kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit në kuptimin abstrakt. Çështja ndryshon kur dy organe kanë mosmarrëveshje për një kompetencë konkrete, e cila mund të lindë në çdo kohë. Me fjalë të tjera, nëse mosmarrëveshja e kompetencës buron nga ligji, kjo nuk do të thotë se vepron në mënyrë të vetvetishme parashkrimi trevjeçar. Në mosmarrëveshjen me palë kundërshtare që pretendojnë të njëjtën kompetencë nuk mund të ketë parashkrim në raport me ligjin. Në të kundërt, do të pranohej se shteti është i pafuqishëm të zgjidhë konfliktet e brendshme dhe se ai nuk ka asnjë mundësi të shpëtojë nga funksionimi antikushtetues i tij. Ky lloj qëndrimi brenda shtetit, për shkak të kalimit të afatit, nuk

[*] Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 10, pika 3/1, 32, 44 etj.

mund të gjejë mbështetje kushtetuese. Arsyeja është sepse veprimtaria shtetërore nuk mund të lihet të devijojë në mënyrë antikushtetuese. Përndryshe, do të ndodheshim para situatave kur mosmarrëveshja e lindur për shkak të ligjit *de jure* do të parashkruhej brenda tre vjetëve nga miratimi i tij, ndërkohë që mosmarrëveshja e lindur *de facto* jo.

Pikërisht për këtë arsye, në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", procedurat që parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës janë formuluar ndryshe nga procedurat e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Afati gjashtëmujor që parashikon neni 55 i këtij ligji lidhet me çastin e lindjes së konfliktit dhe jo me kohën e hyrjes në fuqi të ligjit burim konflikti. Prandaj, argumenti i subjektit të interesuar nuk mund të përbëjë kurrsesi zgjidhje kushtetuese të çështjes.

Gjykata Kushtetuese e çmon si të pabazuar edhe pretendimin tjetër të subjektit të interesuar se kjo çështje nuk mund të shqyrtohet përsëri, për shkak të pengesës ligjore që krijohet nga parimi *res judicata* (gjë e gjykuar).

Në të drejtën kushtetuese, *res judicata* njihet si një nga tre format e efekteve që merr vendimi gjyqësor në procedurën abstrakte të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në aspektin formal e procedural, *gjë e gjykuar* nënkupton përfundimin, në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa, në atë substancial, nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit. Ky parim është i zbatueshëm jo vetëm ndaj palëve në gjykim, por edhe ndaj të gjitha autoriteteve publike brenda juridiksionit që janë të interesuara ose të përfshira në përmbajtjen e vendimit të gjykatës.

Tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur nuk është shprehur papajtueshmëria kushtetuese e normës juridike, kërkuesi nuk ndalohet të bëjë përsëri të njëjtën kërkesë me motiv rishikimin e normës për pakushtetutshmëri. Kjo gjë varet nga pjesa arsyetuese e vendimit, sepse rrëzimi i kërkesës mund të jetë vendosur për shkaqe të tjera.

Vendimi nr.2, datë 25.1.1999 i Gjykatës Kushtetuese, të cilit i referohet subjekti i interesuar, nuk ka marrë përsipër të trajtojë në të gjitha përmasat kushtetutshmërinë e dispozitave objekt shqyrtimi. Qëndrimi që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese ka qenë, ashtu siç është vepruar në të gjitha kërkesat e paraqitura për shqyrtim, i kushtëzuar, kryesisht nga pretendimet që kanë parashtruar kërkuesit në atë gjykim. Nenet 9, 10, 19 dhe 75 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" përbëjnë dispozitat ligjore që kundërshtohen për së dyti nga kërkuesi në këtë gjykim të ri dhe që mund ta bëjnë të diskutueshëm ekzistencën e *res judicata*.

Nga shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura, si në kërkesën e parë, ashtu edhe në të dytën, Gjykata Kushtetuese konstaton se midis tyre ka diferenca të theksuara në referimin te baza juridike, dispozitat e kundërshtuara dhe në shkaqet kushtetuese që parashtrohen. Vendimi i mëparshëm i kësaj gjykate nuk përbën asnjë pengesë të aspektit kushtetues, për sa kohë që kërkuesit kanë shtuar ndjeshëm si numrin e dispozitave ligjore që kundërshtohen, ashtu edhe argumentet për papajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën dhe veçanërisht me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Në kërkesën e re objekt shqyrtimi, janë parashtruar shkaqe të reja që nuk janë shfaqur në vendimin e parë dhe që, për pasojë, nuk vepron parimi *res judiciata.*

Argumenti kryesor i kërkuesit mbështetet në faktin se te vendimi i mëparshëm i Gjykatës Kushtetuese nuk bëhet referencë në aktet juridike bazë që rregullojnë decentralizmin e pushtetit dhe autonominë vendore në fushën e planifikimit urban dhe të kontrollit të territorit, për arsye të miratimit të tyre nga ligjvënësi pas këtij vendimi. Për rastin në shqyrtim, Kuvendi i Shqipërisë, pas vendimit nr.2, datë 25.1.1999 të Gjykatës Kushtetuese, ka miratuar ligjin nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", si dhe ligjin nr.8927, datë 25.7.2002 "Për prefektin".

Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese duke qenë e orientuar në kuptimin doktrinar që i jepet parimit *res judicata* mban në vëmendje të veçantë edhe arsyet dhe shkaqet e përligjura dhe objektive të cilat diktojnë domosdoshmërinë e evoluimit të jurisprudencës kushtetuese dhe përshtatjen e saj me standardet demokratike bashkëkohore. Në këtë drejtim, është për t'u theksuar se Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 131 shkronja "a" të Kushtetutës, ka jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin që, për arsye të ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, të jetë e lirë dhe të mos pengohet në ushtrimin e kompetencës së saj për të vendosur për pajtueshmërinë e ligjit me këtë marrëveshje ndërkombëtare.

Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese, pasi analizoi paralelisht të dyja kërkesat dhe

veçanërisht qëndrimin që ajo ka shprehur në arsyetimin e vendimit nr.2, datë 25.1.1999 konkludon se qoftë në aspektin formal, ashtu dhe në atë substancial nuk ndodhemi përpara gjësë së gjykuar. Ndonëse të dy çështjet kanë ngjashmëri, këndvështrimi aktual i Gjykatës Kushtetuese është drejtuar nga shkaku i ndryshëm ligjor dhe kërkimet përfundimtare të kërkuesit që kanë të bëjnë me zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore dhe papajtueshmërinë e dispozitave ligjore me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore.

Gjykata Kushtetuese konstaton se ndërmjet qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror ka lindur në fakt një mosmarrëveshje për ushtrimin e kompetencave të tyre në fushën e planifikimit, të menaxhimit urban, si dhe të kontrollit mbi territorin. Bashkia Tiranë, si një organ i qeverisjes vendore dhe disa organe që varen nga pushteti qendror, konkretisht KRRTRSH-ja, Ministria e Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit, si dhe Policia Ndërtimore kanë hyrë në një mosmarrëveshje kompetence, gjë që ka sjellë si rrjedhojë edhe mosfunksionimin normal të veprimtarisë së tyre ligjore e kushtetuese. Mosmarrëveshja e kompetencës ka lindur për shkak se ligji ka përcaktuar një lloj dualiteti në organet që duhet të ushtrojnë kompetencat në fushën e planifikimit urban dhe të kontrollit mbi territorin. Kështu dispozita konkrete të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit” kanë parashikuar ushtrimin e disa prej kompetencave të organeve të qeverisjes vendore nga organe të pushtetit qendror. Çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e dhënies së lejes së ndërtimit për objekte të rëndësishme në qendrat e qyteteve, të drejtën e thirrjes së mbledhjes të organeve të specializuara në fushën e urbanistikës (KRRT-së bashkisë-së), të drejtën e shfuqizimit të akteve të tyre, si dhe të drejtën e vendimmarjes për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme, ligjet e sipërcituara ia kanë njohur disa organeve të pushtetit qendror, respektivisht, KRRTRSH-së, si organi i lartë shtetëror që vepron pranë Këshillit të Ministrave, Prefektit, i cili është përfaqësuesi i pushtetit qendror në qeverisjen vendore, si dhe Policisë Ndërtimore, që sipas ligjit varet nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Pra, nga ekzistenca e kësaj situate ligjore, që ka sjellë edhe një situatë faktike konfliktuale rezulton se baza dhe shkaku i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore në fushën e planifikimit e të menaxhimit urban, si dhe të kontrollit të territorit janë normat ligjore, të materializuara në aktet përkatëse të zbatimit të këtyre normave. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese në rastin në shqyrtim mbetet zgjidhja e kësaj mosmarrëveshje kompetencash të krijuara ndërmjet qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror, nëpërmjet konstatimit dhe evitimit të shkakut kryesor nga i cili ka lindur mosmarrëveshja, si dhe përcaktimit të organit përkatës shtetëror që ka në kompetencë zgjidhjen e çështjeve konkrete, objekt i mosmarrëveshjes.

Në metodën e saj për arritjen në një konkluzion të drejtë, Gjykata Kushtetuese vlerëson të nevojshme t’i japë përgjigje kërkimeve të parashtruara nga palët në proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave nëpërmjet kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike përkatëse, të analizuar në raport me Kartën Europiane të Automisë Vendore, si dhe të kryejë interpretimin përfundimtar të nenit 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të dispozitave të tjera të saj, që sanksionojnë çështjet që lidhen me parimin e decentralizmit të pushtetit dhe të autonomisë vendore.

Thelbi i nenit 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë janë parimi i decentralizmit të pushtetit dhe i autonomisë vendore. Në të vërtetë, ai që decentralizohet është ushtrimi i pushtetit në formë ndarjeje të kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Sistemi ynë normativ nuk është i decentralizuar, por hierarkik sipas strukturës së parashikuar në nenin 116 të Kushtetutës. Në një sistem të tillë normativ bëhet pikërisht detajimi kushtetues i ndarjes së kompetencave në nivelin vendor. Normat juridike vendore nuk mund të kenë natyrë primare, për arsye se qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë konturohet në sistemin e një shteti unitar. Për shkak të unitarizmit të shtetit shqiptar, sistemi ynë nuk bazohet *në parimin e devolucionit*, që nënkupton dhënie kompetencash nga pushteti qendror njësive vendore.

Qeverisja vendore nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre, nëpërmjet organeve të cilat i zgjedhin vetë, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë. Parimi i decentralizmit të pushtetit është parim thelbësor, mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore. Ai ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të qeverisjes vendore, si dhe raporti që ajo ka me pushtetin qendror varen nga kuptimi kushtetues dhe ligjor që u jepet

decentralizmit të pushtetit, autonomisë vendore dhe vetëqeverisjes.

Decentralizmi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të decentralizmit qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit "ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t'i takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve."[*]

Decentralizmi ka përmasat e veta, politike, administrative dhe financiare, të cilat ndërveprojnë midis tyre dhe përfaqësojnë në thelb tre komponentët e pushtetit. Decentralizmi është *politik* dhe përfshin transferimin e autoritetit politik në nivelin vendor nëpërmjet një sistemi përfaqësimi të bazuar në zgjedhjet politike vendore. Nëpërmjet decentralizmit *administrativ* transferohet përgjegjësia për çështjet e administrimit të disa funksioneve publike qendrore te njësitë vendore, ndërsa decentralizmi financiar i referohet zhvendosjes së pushtetit financiar pranë nivelit vendor, me qëllim pajisjen e tij me autoritet më të madh në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përshtatur atë koncept decentralizmi që i referohet ristrukturimit ose riorganizimit të pushtetit dhe që bën të mundur krijimin dhe funksionimin sipas parimit të subsidiaritetit të një sistemi bashkëpërgjegjësie të institucioneve të qeverisjes në nivel qendror dhe vendor. Ky koncept i përgjigjet më mirë nevojës për një autonomi substanciale të qeverisjes vendore, aftësisë së kësaj të fundit për të lehtësuar pushtetin qendror, si edhe dobisë për zgjidhjen e problemeve vendore.

Autonomia është një regjim i tillë juridik, në të cilin organet e njësive vendore veprojnë në pavarësi për zgjidhjen e atyre çështjeve që Kushtetuta dhe ligjet ua kanë lënë atyre në kompetencë. Aspektin e vet më të dukshëm, autonomia e pushtetit vendor e shpreh në ndarjen e kompetencave, e cila ka të bëjë me iniciativën që kanë ose duhet të kenë, në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit, organet e qeverisjes vendore për të vendosur vetë për problemet që hyjnë në juridiksionin e tyre.

Për këtë çështje, nga një vështrim krahasues në legjislacionin bashkëkohor konstatohen dy prirje. Nga njëra anë, përkrahet ideja e parashikimit të kompetencave të qeverisjes vendore me ligj të veçantë, ashtu siç aplikohet edhe mundësia që këto kompetenca të sanksionohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta.

Parashikimi në ligj i kompetencave për pushtetin vendor nuk përjashton mundësinë, përkundrazi përforcon mendimin, se ato mund të ndryshohen, të kufizohen ose të hiqen nga pushteti qendror në çdo kohë, sidomos kur shfaqet mosmarrëveshje midis pushtetit qendror dhe atij vendor ose edhe në raste të ndryshimit të raportit të forcave politike. Kështu, në një sistem të qeverisjes vendore që bazohet në *devolucionin* (kalimin e kompetencave) dhe *dekocentrimin* (shpërqendrimin e autoritetit)[†]; njësitë vendore nuk vetëqeverisen, por vetadministrohen. Në sistemin e vetadministrimit, zgjidhja e çështjeve vendore është deleguar nga qendra dhe ato shihen si çështje publike të përgjithshme që lindin në terren vendor. Dhënia me ligj e kompetencave nga parlamenti, (për rrjedhojë, edhe modifikimi i tyre) ose delegimi i kompetencave të pushtetit qendror njësive vendore (logjikisht, edhe tërheqja e tyre) shpien në sistemin, ku njësitë lokale vetadministrohen; pra ato zgjidhin çështjet e tyre në mënyrë autonome vetëm brenda kufijve të përcaktuar nga ligji. Vetadministrimi në këtë formë nuk është gjë tjetër veçse çlirim dhe lehtësim barre i pushtetit qendror. Kjo mënyrë organizimi nuk mund të quhet vetëqeverisje.

Në një sistem vetëqeverisës, parimi i subsidiaritetit kërkon që problemi të vështrohet në drejtim të anasjellë, si çështje vendore që ka ndikim në interesin e përgjithshëm. Kjo do të thotë se ndërsa vetadministrimi ndërtohet nga lart, vetëqeverisja ndërtohet nga poshtë. Pra, vetëqeverisja vendore është institucion, me anë të të cilit sanksionohet e drejta e vetëqeverisjes së shtetasve, si e drejtë politike e tyre. Njësitë vendore vetëqeverisëse nuk mund të pengohen dhe as të reduktohen, në hapësirën juridiksionale të tyre, nga organet qendrore të pushtetit, pasi ato kanë fushën e tyre të veprimtarisë së parashikuar nga Kushtetuta. Për shkak të karakterit që ka në ndarjen dhe balancimin e pushtetit; vetëqeverisja vendore përbën një bazë thelbësore për rendin demokratik dhe shtetin e së drejtës.

[*] Neni 4 pika 3 i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore.

[†] Në një kuptim të zgjeruar, devolucion do të thotë rezultat i kalimit të kompetencave nga pushteti qendror tek ai vendor; ndërsa dekoncentrim do të thotë shpërndarje e autoritetit vendimmarrës qendror në nivele më të ulta të pushtetit vendor.

Nga kjo pikëpamje, përcaktimi i kompetencave drejtpërdrejt në Kushtetutë paraqet rëndësi të veçantë, sepse një zgjidhje e këtillë do ta bënte të pafuqishme prirjen qeverisëse, për t'i ndryshuar ligjet në çdo kohë. Sigurisht, një zgjidhje e tillë e garanton qëndrueshmërinë e kompetencave të pushtetit vendor dhe e bën të pafuqishëm presionin politik të qeverisë që mund të ushtrohet në çdo kohë.

Pikërisht një model të tillë ka zgjedhur Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Vetëqeverisja vendore paraqitet me një status kushtetues dhe pavarësia e saj është e garantuar nëpërmjet saj. Kjo pavarësi qëndron në të drejtën që kanë shtetasit për të formuar organet përfaqësuese dhe për të ushtruar funksionin e vetëqeverisjes (referendumeve) [nenet 108/4; 109, 110 të Kushtetutës; në pavarësinë organizative të institucioneve vendore (neni 113); në ushtrimin e punëve brenda juridiksionit të tyre, pa ndërhyrjen e organeve qendrore të pushtetit (neni 113); në ekzistencën e mjeteve financiare dhe të mjeteve të tjera, me të cilat ajo disponon në mënyrë të pavarur (nenet 111, 113/b,c,ç); në ekzistencën e administratës së pavarur pa përzierjen e organeve qendrore (neni 113/d); në ekzistencën e normave për funksionimin e vetëqeverisjes vendore dhe mbrojtjes kushtetuese të të drejtave vetëqeverisëse (nenet 113/, pika 2, 3) etj.].

Kompetencat e sanksionuara, si edhe parimet, mbi bazën e të cilave mund t'u kalohen me ligj kompetenca të tjera njësive të qeverisjes vendore, janë elemente të rëndësishme që kanë gjetur pasqyrim në Kushtetutë, gjë që përbën një veçori karakteristike të saj. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar një sistem të politikës dhe të administrimit vendor autonom që është diametralisht i kundërt me atë të sistemit shtetëror njëpartiak. Duke ngritur një sistem të tillë, është synuar t'u vihen pengesa prirjeve të centralizmit burokratik të shtetit. Natyrisht, kompetencat e dhëna nga ligjvënësi organeve të qeverisjes vendore mund të modifikohen ose të tërhiqen nga ai, sipas vlerësimit politik të tij, por Kushtetuta parashikon rezervën e saj për kompetencat themelore të caktuara në Pjesën e Gjashtë, të cilat nuk mund të preken nga ligjvënësi, pasi çdo cenim i tyre kontrollohet nga Gjykata Kushtetuese.

Pra, megjithëse karakteristika e qeverisjes vendore, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është kombinimi i *regjimit konstitucional* me *devolucionin parlamentar*, është pikërisht ekzistenca e kompetencave kushtetuese për pushtetin vendor që e ngre këtë të fundit në shkallën e njësisë vetëqeverisëse, duke mos e kuptuar atë si njësi thjesht vetadministruese. Gjithashtu, Kushtetuta nënkupton edhe respektimin e dy kritereve të rëndësishme, *ekskluzivitetin e* kompetencës, - sipas të cilit, në çështjet lokale nuk mund të përzihet shteti dhe *komplementaritetin*, - kur njësitë vendore janë në pamundësi të zgjidhin çështjet e tyre, pushteti qendror angazhohet qoftë nëpërmjet ndihmës materiale-financiare, qoftë nëpërmjet delegimit të kompetencave të administratës shtetërore. Të gjitha këto përfundime që rrjedhin nga dispozitat kushtetuese janë shprehje e autonomisë vendore. Në këtë kuptim, autonomia është vetëqeverisje dhe nga ana tjetër vetëqeverisja parakupton autonomi kushtetuese.

Mbështetur në analizën doktrinare që iu bë parimit të decentralizmit të pushtetit e të autonomisë vendore, bazuar edhe në standarde demokratike që sanksionon Karta Europiane e Autonomisë Vendore, Gjykata Kushtetuese vlerëson të domosdoshme të zgjidhë mosmarrëveshjen ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, e cila shprehet si mosmarrëveshje kompetence dhe që rezulton të jetë e pranishme në ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Kjo mosmarrëveshje ka lindur për shkak të ushtrimit të kompetencave në fushën e planifikimit urban, si dhe të kontrollit mbi territorin në mënyrë të dubluar nga organe të të dy pushteteve, veprime të cilat kanë pasur si pasojë mosfunksionimin normal të veprimtarisë shtetërore. Është pikërisht kjo ndarje kompetencash që i heq mundësinë juridike Bashkisë, si njësi bazë e qeverisjes vendore, për të vendosur për probleme dhe çështje që janë në kompetencë të saj, në bazë të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, por që me ligje të veçanta i janë dhënë pushtetit qendror. Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim pikërisht këtë mënyrë të ndarjes së kompetencave nga ligjvënësi, duke e trajtuar problemin jo si vullnet ose dëshirë të pushtetit qendror për t'u transferuar kompetenca organeve të qeverisjes vendore, por si detyrim të tij për të mos cenuar me ligj ato parime kushtetuese që qëndrojnë në themelin e dy shtyllave të qeverisjes vendore, të decentralizmit të pushtetit dhe të autonomisë vendore.

Për arsyet e lartpërmendura, objekt i shqyrtimit kushtetues do të bëhen edhe dispozitat e sipërcituara ligjore. Në aspektin e kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, në dallim nga neni 131 shkronja "a" i Kushtetutës, neni 131, shkronja "ç", i zbërthyer hollësisht në nenet 54, 54 dhe 56 të ligjit të organik të Gjykatës Kushtetuese, i mundëson kësaj të bëjë shqyrtimin jo vetëm të

kushtetushmërisë, por edhe të ligjshmërisë së aktit, objekt shqyrtimi. Për këtë qëllim, dispozitat ligjore të sipërcituara, që janë bërë shkak për mosmarrëveshjen e kompetencës, do të krahasohen me konceptin kushtetues të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe të autonomisë vendore dhe posaçërisht me standardet demokratike që njeh Karta Europiane e Autonomisë Vendore.

Neni 9, paragrafi i parafundit i ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", që kundërshtohet si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, parashikon si kompetencë të KRRTRSH-së miratimin e lejeve të ndërtimit për objekte të rëndësishme në qendrat e qyteteve, studimet urbanistike të të cilave miratohen prej tij.

Duke iu referuar rregullave të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se orientimet kryesore që ajo përcjell te shtetet anëtare, nënshkruese të saj për një kuptim të drejtë të parimeve të demokracisë e të decentralizmit të pushtetit, kërkojnë "ekzistencën e bashkësive vendore të pajisura me organe vendimore të formuara në mënyrë demokratike dhe që gëzojnë një autonomi të gjerë *për sa u përket kompetencave, mënyrave të ushtrimit* të këtyre të fundit dhe *mjeteve të nevojshme për përmbushjen e misionit të tyre*."

Kompetencat me të cilat ligji pajis organet e qeverisjes vendore, duhet të jenë të tilla që një pjesë e mirë e çështjeve publike të rregullohen sipas parimit të subsidiaritetit. E drejta ligjore për të rregulluar dhe menaxhuar çështje të caktuara publike duhet të ushtrohet nga organe që qëndrojnë sa më afër qytetarëve dhe të shoqërohet edhe me mjete efektive për konkretizimin e tyre. Në realitet, shumë çështje kanë implikime si vendore, ashtu edhe kombëtare dhe përgjegjësia për to ndryshon në hapësirë dhe në kohë dhe, për më tepër, kjo përgjegjësi mund të ndahet edhe ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Gjithsesi, kufizimi i veprimtarisë së autoriteteve vendore vetëm në çështje që nuk kanë implikime të gjera, mbart rrezikun për t'i shndërruar ato në autoritete me një rol të parëndësishëm. Nga ana tjetër, është e nevojshme që pushtetit qendror t'i rezervohen disa funksione të rëndësishme me rëndësi kombëtare e strategjike. Përcaktimi i interesit të komunitetit lidhet edhe me nevojën e ekzistencës së kufijve për vetë pushtetin vendor, i cili nuk duhet të tejkalojë kompetencat e tij duke vendosur për çështje që i përkasin një vendimmarrje të pastër politike ose për çështje që kanë pasoja ekonomike për të gjithë vendin dhe jo vetëm për komunitetin vendor përkatës.

Qëllimi i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore është që shtetet palë të krijojnë kuadrin e nevojshëm që autoritetet vendore të kenë një diapazon të gjerë përgjegjësish, të mundshme për t'u realizuar në nivel vendor. Kur fushat e veprimtarisë kanë implikime në nivel vendor, është e rëndësishme që në konceptimin e autoriteteve vendore që veprojnë për të zhvilluar mirëqenien e përgjithshme të banorëve të tyre, ato të kenë të drejtën për të ushtruar iniciativën në këto çështje. Prandaj, sipas paragrafit 3 të nenit 4 të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, ushtrimi i përgjegjësive duhet të shkojë drejt decentralizmit. Ky parim kërkon që, përveç rasteve kur natyra dhe përmasa e problemit është e tillë që i takon një zone shumë të madhe territoriale dhe me interesa të rëndësishme ekonomike, zgjidhja i duhet besuar qeverisë vendore.

Në nenin 9 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", i vështruar në tërësinë e tij, konstatohet se KRRTRSH-ja, si organi më i lartë shtetëror në fushën urbane, miraton pothuajse të gjitha studimet me karakter madhor, gjë që kuptohet nga përdorimi, në këtë dispozitë ligjore, i shprehjeve *"rajonale", "sipërfaqe mbi 10 hektarë", "qyteteve me popullsi mbi 50.000 banorë", "porteve", aeroporteve dhe zonave strategjike"* etj. Duke i analizuar rregullimet e mësipërme në frymën e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, është e lejueshme që çështje me rëndësi kombëtare e strategjike për interesat e vendit dhe që lidhen me miratimin e masterplaneve dhe të studimeve urbanistike rajonale e më gjerë, të ushtrohen nën autoritetin e pushtetit qendror, i cili është përgjegjës për politikën e zhvillimit ekonomik e politik të vendit. Megjithatë, do të konsiderohej si cenim i së drejtës për vetëqeverisje të pushtetit vendor, nëse ligjvënësi, duke u hequr kompetenca organeve vendore, do ta dobësonte aq shumë rolin e këtyre saqë ekzistenca ose vetëqeverisja e tyre do të bëheshin të pandjeshme. Prandaj, përqendrimin te pushteti qendror i të drejtave që lidhen me miratimin e lejeve të ndërtimit, të cilat njihen me termat ligjorë si *"kompetenca të veta"* dhe ekskluzivitet i organeve të qeverisjes vendore, Gjykata Kushtetuese e vlerëson si tejkalim të standardeve kushtetuese dhe të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore. Veç kësaj, edhe në pikëpamje të teknikës legjislative, formulimi i dispozitës është evaziv dhe hap shtegun për keqinterpretim, sepse nuk jep përkufizim të qartë teknik e ligjor për termat *"objekte të rëndësishme"* dhe *"qendrat e qyteteve"*, gjë që krijon ngatërresa kompetencash ndërmjet qeverisjes vendore dhe

pushtetit qendror, për aq kohë sa edhe neni 20 i këtij ligji i njeh KRRT-së së bashkisë të drejtën për të miratuar sheshet dhe lejet e ndërtimit në juridiksionin përkatës.

Në këtë optikë, Gjykata Kushtetuese çmon se në nenin 9 paragrafi i parafundit, fraza "*Lejet e ndërtimit për objekte të rëndësishme në qendrat e qyteteve, studimet urbanistike të të cilave miratohen prej tij"*, është në papajtueshmëri me parimin e decentralizmit të pushtetit dhe të autonomisë vendore të sanksionuar në Kushtetutë dhe në Kartën Europiane të Autonomisë Vendore.

Neni 10 i ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", që i jep të drejtën KRRTRSH-së të shfuqizojë vendimet e paligjshme të KRRT-ve të bashkive, mbi bazën e të cilit kanë dalë akte juridike zbatuese, përbën shkakun tjetër të lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror. Në legjislacionin shqiptar, krahas së drejtës ligjore të parashikuar në dispozitën e mësipërme, në ligjin nr.8927, datë 25.7.2002 "Për prefektin", gjendet e sanksionuar edhe e drejta e prefektit për të pezulluar aktet e paligjshme të organeve të qeverisjes vendore dhe për t'i dërguar ato në gjykatë me qëllim shfuqizimin e tyre. Pra, legjislacioni në fuqi parashikon dy institucione të pushteteve të ndryshme që kanë të drejtën e shfuqizimit të akteve të KRRT-së së bashkisë, nga njëra anë gjykatën dhe nga ana tjetër KRRTRSH-në. Në një situatë të tillë ligjore çështja shtrohet se cili duhet të jetë organi që, nga pikëpamja e respektimit të parimeve kushtetuese, duhet të shqyrtojë paligjshmërinë e vendimeve të organeve të qeverisjes vendore.

Sipas nenit 8 të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, mbikëqyrja e autoriteteve vendore duhet të synojë vetëm garantimin e pajtueshmërisë me ligjin, duke përjashtuar çdo kontroll për dobishmërinë e veprimeve që përfshihen në sferën e përgjegjësive të autoriteteve vendore. Për këtë, respektimi i parimit të subsidiaritetit dhe të përpjesëtueshmërisë mbeten aspektet thelbësore të çdo mbikëqyrje administrative të autoriteteve të niveleve më të larta. Gjithashtu, neni 11 i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore u garanton organeve të qeverisjes vendore, kur çmojnë se u janë cenuar ushtrimi i lirë i kompetencave të tyre dhe parimi i autonomisë vendore, të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës që të vendosë nëse një veprim ose mosveprim, vendim ose akt tjetër administrativ është në përputhje me ligjin.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se tek e drejta e prefektit për të pezulluar aktet e organeve të qeverisjes vendore dhe për t'i dërguar ato për shqyrtim në gjykatë, gjen zbatim parimi i kontrollit administrativ të veprimeve të bashkësive vendore që synon të sigurojë respektimin e parimit të ligjshmërisë dhe të parimeve kushtetuese. Mbi këtë bazë, megjithëse kontrolli mbi ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit vendor ushtrohet nëpërmjet pezullimit të tyre për paligjshmëri nga përfaqësuesi i pushtetit qendror, nuk është KRRTRSH-ja organi shtetëror që i jep zgjidhje përfundimtare çështjes, por është pushteti gjyqësor.

Sipas nenit 10 të këtij ligji, organeve të qeverisjes vendore nuk u garantohet mbikëqyrje ligjore në respektim të parimit të kontrollit dhe balancimit të pushteteve, për arsye se e drejta për shfuqizim të akteve juridike drejtpërsëdrejti nga një organ i pushtetit qendror do t'i vendoste ato nën kontrollin hierarkik të tyre. Mbështetur në këto argumente, Gjykata Kushtetuese çmon se rregulli i parashikuar nga kjo dispozitë ligjore, i analizuar në frymën e parimit kushtetues të decentralizmit të pushtetit dhe të autonomisë vendore, rregull që nuk respekton parimin e përpjestueshmërisë midis ndërhyrjes së autoritetit kontrollues dhe rëndësisë së interesave që ai kërkon të mbrojë, bie në kundërshtim me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore. Mbi bazën e këtij argumentimi, Gjykata Kushtetuese nxjerr përfundimin se papajtueshmëria kushtetuese e nenit 10 të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", për arsye të të njëjtit rregullim ligjor, sjell të njëjtën pasojë edhe për nenin 6 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit".

- Neni 19 i ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", që parashikon përbërjen e KRRT-së së Bashkisë, Tiranë me një shumicë të cilësuar nga përfaqësues të pushtetit qendror dhe me pakicën prej 1/3-ës të anëtarëve nga pushteti vendor, përbën një tjetër shkak, nga i cili ka lindur mosmarrëveshja e kompetencës ndërmjet dy pushteteve.

Karta Europiane e Autonomisë Vendore kërkon ekzistencën e organeve vendimore të formuara në mënyrë demokratike dhe që gëzojnë një autonomi të gjerë për sa u përket kompetencave, mënyrave të ushtrimit të tyre dhe mjeteve të nevojshme për përmbushjen e misionit që ato kanë. Planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore dhe përfshihen në konceptin ligjor *"funksionet e veta"*, sipas të cilit, nëpërmjet lirisë dhe autoritetit për të marrë vendime, ato janë përgjegjëse për realizimin e tyre.

Duke iu referuar dispozitës ligjore përkatëse, rezulton se shumica e cilësuar e anëtarëve të

KRRT-së, nuk përfaqësojnë bashkinë. Ekzistenca e një rregullimi normues të tillë, që kërkon minimumin e 2/3-ve të anëtarëve për të konsideruar të vlefshme mbledhjen e KRRT-së, nuk i krijon mundësi autoritetit vendor të gëzojë instrumentet e nevojshme ligjore për ushtrimin normalisht të funksionit dhe të vendimmarrjes në fushën e planifikimit urban, duke e vendosur atë, në këtë mënyrë, nën vullnetin e pushtetit qendror. Për rrjedhojë, neni 19 i ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", bie ndesh me parimin e decentralizmit të pushtetit dhe të autonomisë vendore, parashikuar nga neni 13 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga Karta Europiane e Autonomisë Vendore.

Për sa i takon nenit 21 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", pretendimeve për shkelje të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe të autonomisë vendore, të parashtruara në funksion të papajtueshmërisë me Kushtetutën e me marrëveshjen ndërkombëtare të nenit 19, kërkuesi i ka shtuar dhe argumentet për antikushtetutshmërinë e aktit normativ me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave nr.4, datë 13.12.2005 "Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën". Me vendimin nr.24, datë 10.11.2006, Gjykata Kushtetuese ka vendosur konstatimin e pafuqisë juridike të këtij akti normativ me fuqinë e ligjit. Në këto kushte, kërkesa për nenin 21 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", nuk merret në shqyrtim për shkak të mungesës së objektit konkret të çështjes.

Shkak tjetër që ka krijuar mosmarrëveshje kompetencash ndërmjet qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror rezulton të kenë qenë edhe nxjerrja e disa akteve administrative në zbatim të dispozitave të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" (neneve 54 e 75/2), si dhe të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit" (neneve 2, 3/3 dhe 6).

Duke e analizuar çështjen në tërësi, Gjykata Kushtetuese konstaton ekzistencën e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet organeve të qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror, gjë që ka sjellë si pasojë bllokimin e veprimtarisë shtetërore në fushën urbane, e cila nuk rezulton të jetë e pajtueshme me parimet kushtetuese dhe me rregullat e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore. Kjo mosmarrëveshje kompetencash ndërmjet këtyre organeve bëhet e dukshme në dy drejtime kryesore; në konceptimin e Policisë Ndërtimore, si organ me varësi nga pushteti qendror dhe që ushtron disa nga kompetencat e organeve të qeverisjes vendore në fushën e kontrollit mbi territorin, si edhe në ushtrimin në mënyrë të dubluar të disa kompetencave vendore nga organe që u përkasin pushteteve të ndryshme.

Duke iu referuar nenit 2 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit", rezulton se ky organ varet nga Ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit. Gjithashtu, dispozitat e sipërpërmendura kanë vendosur rregulla që ngarkojnë me kompetenca vendimmarrëse për administrimin dhe kontrollin mbi territorin vendor, organin e specializuar të pushtetit qendror, nga njëra anë, dhe organin e qeverisjes vendore, nga ana tjetër. Pra, ndërsa neni 20 i ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" i njeh të drejtën KRRT-së së bashkisë të vendosë shpalljen si të kundërligjshëm dhe prishjen e volumit të zmadhuar të punimeve në objektit e miratuar, neni 54 i këtij ligji ia ka ngarkuar të njëjtën kompetencë vendimmarrëse edhe Policisë Ndërtimore.

Sipas ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit", Policia Ndërtimore është konceptuar si organ ekzekutiv, i armatosur dhe i specializuar për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën e punimeve të ndërtimit dhe të urbanistikës. Qëllimi i ligjvënësit ka qenë vendosja e këtij organi në dispozicion të veprimtarisë vendimmarrëse të organeve të pushtetit, me qëllim realizimin e funksioneve të tyre në fushën përkatëse. Sidoqoftë, sanksionimi me ligj i varësisë së Policisë Ndërtimore nga pushteti qendror ka ndikuar në mosushtrimin e kompetencës në fushën e planifikimit, të menaxhimit urban dhe të kontrollit mbi territorin nga vetë organet e qeverisjes vendore.

Sipas Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, autoritetet vendore duhet të kenë diapazon të gjerë përgjegjësish, të cilat janë të mundshme për t'u realizuar në nivelin vendor. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, parimi i decentralizmit të pushtetit duhet të përmbajë, në thelbin e vet, përcaktimin e misionit parësor që i ngarkohet pushtetit vendor në administrimin e territorit nën juridiksionin e vet, ku përfshihen edhe çështjet e planifikimit, menaxhimit urban dhe të kontrollit të territorit. Duke i dhënë Policisë Ndërtimore kompetenca për të ndërhyrë pa vendim gjyqësor në veprimtarinë e autoriteteve vendore në fushën e veprave të ndërtimit dhe të planifikimit urban, dispozitat ligjore të sipërpërmendura tejkalojnë standardet kushtetuese dhe normat ndërkombëtare.

Mbështetur në të dhënat e kësaj analize, Gjykata Kushtetuese konkludon se ligjvënësi, nëpërmjet rregullimeve ligjore, duhet të orientojë Policinë Ndërtimore drejt një organi shtetëror të pavarur nga pushteti qendror, që do të duhet të ketë, si detyrë kryesore, kontrollin e zbatimit të standardeve teknike mbi territorin, nën autoritetin e qeverisjes vendore.

Mbi bazën e këtij argumentimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kompetenca e Policisë Ndërtimore për të vendosur prishjen e volumit të punimeve të ndërtuara jashtë projektit të miratuar, parashikuar në nenin 54 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën" si edhe parashikimi i varësisë së këtij organi nga Ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit, të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit", janë të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja "ç", 134, pika 1 shkronja "e", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 54, 55, 56 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit dhe Policisë Ndërtimore, duke përcaktuar, për çdo rast konkret, organin që ka në kompetencë shqyrtimin e çështjeve, objekt i kësaj mosmarrëveshje:

a) Shqyrtimi dhe miratimi i lejeve të ndërtimit, si çështje të planifikimit dhe menaxhimit urban që përfshihen në konceptin ligjor *"funksionet e veta"*, janë kompetencë e plotë dhe ekskluzive e organeve të qeverisjes vendore.

b) E drejta e shfuqizimit të akteve të paligjshme të KRRT-ve që funksionojnë pranë organeve të qeverisjes vendore është kompetencë e organeve të pushtetit gjyqësor.

c) KRRT-ja është organ i specializuar për urbanistikën që ushtron funksionin dhe kompetencat e tij vendimmarrëse në fushën e planifikimit dhe të menaxhimit urban, nën autoritetin e pushtetit vendor.

ç) Të drejtën për të vendosur për prishjen e volumit të punimeve të ndërtuara jashtë projektit të miratuar e ka Këshilli i Rregullimit të Territorit pranë organeve të qeverisjes vendore.

d) Kontrolli i zbatimit të standardeve teknike mbi territorin është në kompetencë të Policisë Ndërtimore që vepron si organ i pavarur nga pushteti qendror, por nën autoritetin e organeve të qeverisjes vendore.

2. Të deklarojë të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, si shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, dispozitat ligjore të mëposhtme:

a) Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", te neni 9, paragrafi i parafundit, frazën "*Lejet e ndërtimit për objekte të rëndësishme në qendrat e qyteteve, studimet urbanistike të të cilave miratohen prej tij"*, nenin 10, 19, si dhe te neni 54, fjalët *"apo Policia e Ndërtimit";*

b) Në ligjin nr.8408, datë 25.09.1998 "Për Policinë e Ndërtimit", te neni 2, frazën "*Policia e Ndërtimit varet nga Ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit*", si dhe nenin 6.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi kategorikisht kundër vendimit të shumicës. Ai vendim bazohet mbi pikëpamje që kapërcejnë kuptimin kushtetues, ligjor e për më tepër doktrinar të "konfliktit të kompetencave".

Pakica është plotësisht e ndërgjegjshme që, në kuadër të implementimit të Kartës Europiane për Autonominë Vendore ekzistojnë një sërë problemesh me karakter administrativ, organizativ e ligjor të cilat patjetër kërkojnë zgjidhje. Në këtë kuadër asnjë të keqe nuk ka nëse organet e pushtetit vendor të pretendojnë për më shumë kompetenca dhe autonomi në menaxhimin e kontrollin e territorit. Por, në rastin në shqyrtim, kërkesa është ngritur në mënyrë thellësisht të gabuar përsa u përket mjeteve të zgjidhjes, sepse rruga normale kushtetuese e përmirësimit të legjislacionit nëpërmjet iniciativave legjislative është zëvendësuar në mënyrë arbitrare, jokushtetuese, me "konflikte të sajuara abstrakte" të kompetencave, të cilave u është vënë vulë me vendimin e shumicës.

Thënë më shkoqur, problemi themelor që përcakton kufirin ndarës midis dy qëndrimeve është: - A ndodhemi apo jo përpara konfliktit të kompetencave midis organeve të pushtetit qendror e atyre lokalë, në kuptim të nenit 131, shkronja "ç" të Kushtetutës; neneve 54, 55, 56 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" si dhe të doktrinës. Pakica ka mendimin jo, duke parashtruar këto argumente:

1. Konflikti i kompetencave duhet të konceptohet si divergjencë e caktuar mendimi apo veprimi të të dy organeve, që pretendojnë ose jo të njëjtën kompetencë. Në rastin konkret nuk ndodhemi para një kushti të tillë. Organet përkatëse qendrore (KKRTSH, Ministria e Transporteve, Ndërtimit etj., Policia Ndërtimore) veprojnë mbi bazën e kompetencave të përcaktuara me ligje, e për pasojë pala tjetër (organet e pushtetit lokal) nuk kanë se si të pretendojnë se këto kompetenca "që u takojnë atyre" i kanë "uzurpuar" në mënyrë të njëanshme organet e pushtetit qendror.

2. Shqyrtimi i konfliktit të kompetencave, nga pikëpamja e doktrinës është një shqyrtim konkret d.m.th., ai përqendrohet në rastet konkrete të cilat janë konkretizuar në akte konkrete të nxjerra nga vetë subjektet në konflikt.

Në rastin në fjalë, Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar kushtetutshmërinë e ligjeve dhe jo rasteve konkrete të konfliktit.

3. Konflikti i kompetencave, në rastin konkret, nuk mund të konceptohet si konflikt që rrjedh nga ligjet apo aktet me fuqinë e ligjit, sepse "në një rast të tillë do të ndodheshim para një kontrolli të kushtetutshmërisë së ligjit, që shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese në rrugë të tjera. Si pasojë, akti që i lë shteg konfliktit mund të jetë një akt i çfarëdo që nuk është një ligj formal ose një akt që ka fuqinë e ligjit. *[1]

Ndryshe nga ky konceptim që rrjedh nga përgjithësimi i jurisprudencës kushtetuese, shumica edhe pse ka pretenduar se ka shqyrtuar e zgjidhur konfliktin e kompetencave, në të vërtetë ka shqyrtuar (në rrugë abstrakte) kushtetutshmërinë e dispozitave ligjore përkatëse. Një zgjidhje e tillë e problemeve të ngritura në kërkesë jo vetëm se është larg qëndrimit përgjithësues të cituar më lart, por vjen ndesh hapur me atë ç'ka përcaktojnë nenet 54, 55, 56 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Sipas kuptimit të këtyre dispozitave, Gjykata Kushtetuese "kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve shqyrton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit". Duke iu referuar dispozitës, lind natyrshëm pyetja: Cilët janë palë në konflikt? A kanë nxjerrë ato ligje apo akte nënligjore? A mundet që palët në konflikt të jenë ekzekutivi me pushtetin vendor e objekt shqyrtimi të jetë ligji? Këtyre pyetjeve, në optikën e vendimit të shumicës ballafaquar me Kushtetutën dhe ligjin, nuk mund t'i jepet përgjigje.

Këtë qëndrim të shumicës, pakica e sheh tek kuptimi dhe interpretimi i pasaktë që i bëhet pikës 2 të nenit 56 të ligjit të lartpërmendur. Sipas mendimit tonë, legjislatori ka përmendur termin "ligj", si dhe ka parashikuar shfuqizimin e tyre si antikushtetues kur janë nxjerrë "nga organet palë në

*[1] T. Martinas "Diritto Konstituzionale" 1997, fq.650

konflikt". Legjislatori fjalën e ka kur konflikti ekziston midis legjislativit dhe organeve të pushteteve të tjera dhe ku objekt mosmarrëveshje mund të jetë ligji. Në rastin e dhënë situata nuk ka qenë e tillë, si për sa i përket subjekteve, ashtu dhe karakterit të normave që atakohen.

4. Neni 56 pika 1 e ligjit, obligon Gjykatën Kushtetuese që në rastet e shqyrtimit të mosmarrëveshjeve të kompetencave të vendosë "se cili organ i pushtetit ka në kompetencë të tij zgjidhjen e çështjes konkrete për të cilin ka lindur mosmarrëveshja".

Për rastin në shqyrtim, Bashkia e Tiranës, ka kërkuar që kompetencat që dispozitat ligjore ua kanë njohur organeve qendrore, t'i njihen asaj. Në këtë situatë, nuk ka asnjë hapësirë kushtetuese e ligjore që Gjykata Kushtetuese (e cila dihet se është "ligjvënës negativ"), të plotësojë vetë *"de facto"* dispozitat e shfuqizuara, duke u shprehur se cili organ duhet që me ligj t'i ushtrojë këto kompetenca.

5. Këto argumente kanë të bëjnë me faktin se në rastin konkret nuk ekziston konflikti i kompetencave dhe për këtë arsye çështja duhej të ishte nxjerrë jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

Por, me qenë se shumica e ka pranuar atë dhe është shprehur edhe për probleme të tjera, kemi mendimin se ky vendim vjen ndesh edhe me vetë praktikën e Gjykatës Kushtetuese të analizuar qartë në vendimin e saj nr. 2, datë 25.1.1999, kur palët ndërgjyqse, shkaku dhe objekti i kërkesës kanë qenë të njëjtë, sidomos për nenet 9, 10 e 19 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën".

Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese, përveç zgjidhjes së çështjes konkrete, ka bërë deklarime e vlerësime të përgjithshme për ligjin në fjalë duke e konsideruar jo vetëm të pajtueshëm me Kushtetutën, por edhe pozitiv dhe që përbën evoluim në konceptin e ndarjes së kompetencave. Duke iu referuar neneve 9 e 10 të ligjit (nene të cilat janë objekt shqyrtimi edhe në vendimin e tanishëm) Gjykata Kushtetuese shprehet në atë vendim se: "Kalimi i kompetencave në këtë fushë nga Këshilli i Ministrave në KKRRTRSH, përbën një evoluim në konceptin e ndarjes së drejtë të kompetencave midis organeve të specializuara dhe nuk prek kompetencat e organeve të pushtetit lokal. Ekzistenca e KKRRTRSH si organ qendror, jo vetëm që nuk cenon parimet kushtetuese, por ajo paraqitet si një domosdoshmëri në kushtet në të cilat ndodhemi për përcaktimin e një politike të drejtë kombëtare në fushën urbane, duke mbajtur parasysh mbrojtjen e interesave kombëtare dhe atyre lokale". Dhe më poshtë thuhet: "Decentralizimi i pushtetit si një parim kushtetues nuk presupozon kompetenca absolute të organeve të qeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre dhe shkëputje të çdo lloj varësie me pushtetin qendror". Ndërsa për vlerësimet që lidhen edhe me nenin 19 të ligjit, kjo Gjykatë është shprehur: "Kjo mënyrë rregullimi e strukturës së organit të KKRRT-së, është pozitive për legjislacionin. Vendosja e kritereve unike në këtë aspekt, nuk përbën kufizim të kompetencave të organeve të qeverisjes vendore ...".

Siç shihet edhe nga këto citime, shumica jo vetëm që ka shqyrtuar një çështje që përbën gjë të gjykuar (të paktën për tre nenet që përmendëm), por për më tepër, ka zbatuar standarde të tjera duke arritur në një përfundim krejt të kundërt me të mëparshmin, gjë që dëshmon për mungesë konsekuence të kontrollit kushtetues.

Ne mendojmë se referimi te Karta Europiane e Autonomisë Vendore për të përligjur këtë ndryshim, nuk është i saktë. Kërkesat themelore të kësaj Karte padyshim që janë pasur parasysh në hartimin e Kushtetutës, pasi nënshkrimi i saj nga pala shqiptare është bërë që në maj të vitit 1998. Nuk është rastësi që neni 13 i Kushtetutës sanksionon qartë dy nga parimet bazë të Kartës, atë të decentralizimit të pushtetit dhe të autonomisë vendore. Mbi këtë bazë është hartuar edhe legjislacioni vijues, i cili në rastin konkret dhe posaçërisht për dispozitat në fjalë, në vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese, jo vetëm që është konsideruar si në përputhje me Kushtetutën, por edhe është vlerësuar si një zhvillim mjaft pozitiv në këtë fushë.

Siç shihet, nga çdo aspekt që të trajtohet, del qartë se vendimi i shumicës nuk qëndron si në aspektin kushtetues e atë ligjor.

Anëtarë: Xh. Zaganjori, K. Peçi. A. Karamuço

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET AUTORITETIT TË KONKURRENCËS DHE KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIO - TELEVIZIONIT

Ky Memorandum lidhet midis:

Autoritetit të Konkurrencës, i njohur më poshtë si “Autoriteti”, i përfaqësuar nga titullari i tij, kryetare znj.Lindita Milo (Lati), që është institucioni përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, është organ publik i pavarur në kryerjen e detyrave të veta. Autoriteti monitoron rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, nxjerr akte detyruese për zbatimin e tyre dhe bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për sigurimin e rregullave të vendosura për konkurrencën, në përputhje me ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”;

dhe

Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit i njohur më poshtë si “KKRT”, i përfaqësuar nga kryetari z. Ledi Bianku, dhe që është organizëm i pavarur, i cili vepron në bazë dhe për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë.

Neni 1
Rëndësia

Duke qenë se:

- konkurrenca e lirë në një treg të caktuar udhëhiqet nga parimi i mundësive për zgjedhje më të mira për konsumatorin, nga suksesi në treg në përputhje me këto zgjedhje;
- pluralizmi në media, parimi themelor i lirisë së ushtrimit të këtij aktiviteti, bazohet para së gjithash në situata konkurrenciale të rregulluara me ligj, ku askush të mos ketë mundësi t’i imponojë mendimin e tij tjetrit, qoftë edhe duke përfituar nga situata antikonkurrenciale ose monopol;
- fusha e politikave audio-vizuale ka një rëndësi të veçantë në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, për shkak të detyrimeve të rëndësishme që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes se Stabilizim-Asocimit;
- angazhimet e marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit synojnë, ndërmjet të tjerash, garantimin e konkurrencës në tregun e rrjeteve të komunikimit dhe shërbimeve në përputhje me rregullat e konkurrencës që zbatohen nga Komuniteti, si dhe harmonizimin e legjislacionit në këtë fushë me *acquis communnitaures*;
- fusha e mediave elektronike ka pësuar zhvillime të qenësishme vitet e fundit në kuadrin e reformimit thelbësor, që synon ndërtimin e një ekonomie të tregut konkurrues në këta sektorë dhe aktualisht ndodhen në një fazë zhvillimi të veçantë, në një mjedis ekonomik të favorshëm;
- KKRT-ja në fushën e mediave elektronike po luan gjithnjë e më shumë një rol më të dukshëm në jetën ekonomike të vendit dhe pritet së afërmi një kontribut edhe më i madh, si rrjedhojë e zhvillimeve të rëndësishme teknologjike dhe ekonomike në fushën e transmetimeve televizive;
- interesi publik për stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin e fushës së mediave elektronike mbetet i veçantë edhe për shkak të problematikës që ka pasur kjo fushë në të shkuarën;
- treguesit e konkurrencës në fushën e mediave elektronike dëshmojnë problematikën e fazës në të cilën ndodhet ai, ku ka zotërim të tregut nga operatorë të veçantë për shkak të strukturës së tij para privatizimit dhe fragmentarizim të tregut nga pikëpamja e moskonkurrimit të një numri të përshtatshëm operatorësh në fushën e mediave elektronike dhe në çdo segment të saj;
- ekzistojnë barriera ligjore, publike e private për investitorët që kërkojnë të hyjnë në këta sektorë;
- Autoriteti dhe KKRT-ja kanë përgjegjësinë ligjore për mbrojtjen e operatorëve dhe konsumatorëve nga veprimet abuzive në tregun e mediave elektronike dhe për garantimin dhe zbatimin e rregullave të konkurrencës në këtë fushë.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të rregullave për një konkurrencë të lirë dhe efektive në fushën e mediave elektronike.

Neni 3
Baza ligjore

Ky Memorandum bazohet në të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në ligjin nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (veçanërisht neni 70), si dhe në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 7 pika 4 dhe 137/5).

Neni 4
Forma e bashkëpunimit

Palët bien dakord si më poshtë:

1. Institucionalizohet, sipas këtij Memorandumi dhe akteve të tjera të nevojshme të pranuara nga palët, bashkëpunimi reciprok në përmbushje të detyrimeve ligjore të ndërsjella në sferën e forcimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në fushën e mediave elektronike.

2. Palët do të bashkëpunojnë për të bërë studime tregu lidhur me gjendjen e konkurrencës dhe me propozimet për rregullimet ligjore e nënligjore për të përmirësuar situatën aktuale në këtë treg lidhur me treguesit e konkurrencës.

3. Autoriteti bashkëpunon për rritjen e një konkurrence të lirë dhe efektive duke dhënë dhe mendimet e tij në rastet e kufizimit, ndërhyrjes dhe deformimit të tregut në fushën e mediave elektronike.

4. KKRT-ja angazhohet për rivlerësimin e akteve normative e jonormative të hartuara prej tij, duke synuar përmirësimin e standardeve dhe kushteve për një konkurrencë të lirë dhe efektive në sektorët përkatës, në përputhje me standardet europiane në këtë fushë.

5. Të gjitha aktet ligjore, normative e jonormative që do të hartohen, në lidhje me operatorët e kësaj fushe dhe që referojnë kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin e produkteve dhe shërbimeve dhe ekskluziviteteve për veprimtari të caktuara, imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushte të shitjes etj., do të konsultohen paraprakisht me Autoritetin me qëllim garantimin e standardeve për një konkurrencë të lirë dhe efektive.

6. KKRT-ja angazhohet që të mos përdorë mekanizma të mbikëqyrjes (rezerva, garanci, madhësi të shërbimeve të ofruara apo të furnizuara, nivel likuiditeti etj.), që diskriminojnë apo favorizojnë operatorë të veçantë që veprojnë në treg.

7. KKRT-ja bie dakord që, duke mos mënjanuar interesin publik të sektorit, të fillojë procesin e liberalizimit dhe përafrimit gradual me standardet europiane, të procedurave të licencimit, të kërkuara për hyrjen në tregun e mediave elektronike, të kufizimeve penguese të tyre, si dhe të treguesve të mbikëqyrjes duke eliminuar praktikat administrative që dëmtojnë konkurrencën.

8. KKRT-ja angazhohet që, në veprimtarinë e saj mbikëqyrëse dhe rregulluese të operatorëve të licencuar prej saj, si dhe në procesin e miratimit të licencave të reja dhe në bashkimet e mundshme të këtyre operatorëve, të respektojë rregullat e konkurrencës për të mos lejuar operatorë me pozicion zotërues në treg, të mbulojë gjithë territorin e tregut të brendshëm me operatorë konkurrentë në tregtimin e shërbimeve.

9. Në mënyrë të veçantë, KKRT-ja, përmes mbikëqyrjes së kushteve të tregtimit të shërbimeve, do të synojë:

a) ndalimin e kufizimeve horizontale të konkurrencës nëpërmjet kontratave të përbashkëta (çmimet e shërbimeve, territorin e tregjeve etj.);

b) ndalimin e kufizimeve vertikale të konkurrencës (diskriminim për klientë të ndryshëm në të njëjtin treg, diskriminimi i kufizimeve dhe kërkesave specifike për garanci e kushte të tjera për klientë me kushte të njëjta në të njëjtin treg etj.).

10. Autoriteti dhe KKRT-ja do të publikojnë dhe/ose shkëmbejnë zyrtarisht të dhëna dhe informacione, në masën që lejojnë dhe detyrojnë ligjet ku bazohet ky Memorandum, duke respektuar në rast nevoje karakterin e tyre konfidencial, dhe që kanë të bëjnë me problemet e konkurrencës në fushën e mediave elektronike.

11. Secila prej palëve do të emërojë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e

bashkëpunimit, sipas formave që përcaktohen nga ky Memorandum.

Neni 5
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Ky Memorandum nënshkruhet sot më datë 5.12.2006 në dy kopje origjinale. Memorandumi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PËR AUTORITETIN E KONKURRENCËS	PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT
KRYETARI	KRYETARI
Lindita Milo (Lati)	**Ledi Bianku**

UDHËZIM
Nr.11, datë 5.12.2006

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 31 pika 1 germa b, nenit 45 e vijues të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të komisionit të qendrës së votimit, caktimin e rregullave për zhvillimin e mbledhjeve dhe marrjen e vendimeve.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Komisioni i qendrës së votimit është organ kolegjial. Ai përgjigjet për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit.
2. KQV-ja ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme, profesionale dhe transparente. Të drejtat dhe detyrat e KQV-së përcaktohen në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të KQZ-së.

PJESA E II
PËRBËRJA E KQV-SË

Neni 3
Ngritja e KQV-së

1. Anëtarët e KQV-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, emërohen nga KZQV-ja me propozime nga partitë politike si më poshtë:
- 1 anëtar nga Partia Demokratike e Shqipërisë;
- 1 anëtar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
- 1 anëtar nga Partia Republikane Shqiptare;

- 1 anëtar nga Partia Demokrate e Re;
- 1 anëtar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë;
- 1 anëtar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

2. Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KQV-ve nga Partia Demokratike e Shqipërisë, ndërsa në gjysmën tjetër nga Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 5 të këtij udhëzimi.

3. KZQV-ja emëron anëtarët e KQV-së jo më vonë se pesë ditë nga paraqitja e propozimeve. Në çdo rast emërimi i tyre bëhet jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve.

a) Në komisionet e qendrave të votimit, në të cilat anëtari i shtatë i përket Partisë Demokratike, KZQV-ja emëron kryetarin e KQV-së sipas propozimit të paraqitur nga kjo parti. Në këto komisione, KZQV-ja emëron zëvendëskryetar anëtarin e propozuar nga Partia Socialiste.

b) Në komisionet e qendrave të votimit në të cilat anëtari i shtatë i përket Partisë Socialiste, KZQV-ja emëron kryetarin e KQV-së sipas propozimit të paraqitur nga kjo parti. Në këto komisione, KZQV-ja emëron zëvendëskryetar anëtarin e propozuar nga Partia Demokratike.

4. KZQV-ja emëron sekretarin e KQV-së me propozim të partisë politike, e cila ka paraqitur propozimin për zëvendëskryetarin e KQV-së.

Neni 4

Paraqitja e propozimeve nga partitë politike

1. Propozimet për anëtarë të KQV-së paraqiten nga partitë politike të përcaktuara në nenin 3 pika 1 të këtij udhëzimi. Partitë politike mund t'u delegojnë degëve lokale të tyre të drejtën e propozimit për anëtarë të KQV-ve që përfshihen në territorin që mbulon dega lokale përkatëse.

2. Propozimi për anëtarët dhe sekretarin e KQV-së përmban emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, adresën e vendbanimit, si dhe arsimin e personit që propozohet.

Neni 5

Caktimi i anëtarit të shtatë të KQV-së

1. KZQV-ja cakton partinë politike që ka të drejtë të propozojë anëtarin e shtatë të KQV-së, sipas kësaj procedure:

a) KZQV-ja rendit qendrat e votimit, duke nisur nga QV-të me numër rendor më të vogël dhe duke vazhduar në rend rritës, të gjitha QV-të që ndodhen brenda zonës zgjedhore.

b) Në rastet kur një QV është krijuar rishtazi dhe ka numër pesëshifror, atëherë kjo QV renditet menjëherë pas QV-së që ka numrin të njëjtë me katër shifrat e para të QV-së së krijuar rishtaz.

c) KZQV-ja emëron anëtarin e shtatë të KQV-ve të renditura me numër tek, me propozim të partisë politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZQV-së.

d) KZQV-ja emëron anëtarin e shtatë të KQV-ve të renditura me numër çift, me propozim të partisë politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZQV-së.

Neni 6

Emërimi i anëtarëve të KQV-së

KZQV-ja, pasi konstaton se propozimet janë në përputhje me kërkesat e neneve 45/1 dhe 45/2 të Kodit Zgjedhor, emëron me vendim anëtarët e KQV-së. Për emërimin e tyre KZQV-ja përdor modelin 23 V, miratuar me vendim të KQZ-së, nr.76, datë 20. 9.2006.

Neni 7

Emërimi i kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KQV-së

1. Për emërimin e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KQV-së, KZQV-ja përdor modelin 24 V, miratuar me vendim të KQZ-së, nr.76, datë 20.9.2006.

2. Sekretari i KQV-së emërohet me propozim të partisë, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KQV-së.

Neni 8
Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KQV-së

1. Anëtari dhe sekretari i KQV-së shkarkohen nga detyra sipas përcaktimeve të nenit 45/3, pika 1, të Kodit Zgjedhor.

2. Anëtari dhe sekretari i KQV-së lirohen nga detyra sipas përcaktimeve të nenit 45/3, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

3. Shkarkimi dhe lirimi bëhet me vendim të KZQV-së.

Neni 9
Plotësimi i vendit vakant

Kur vendi i një anëtari të KQV-së mbetet vakant, KZQV-ja i kërkon menjëherë partisë politike përkatëse të paraqesë propozimin për anëtarin e ri. Emërimi i anëtarit të ri bëhet sipas afateve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 45 pika 4 dhe 5 të Kodit Zgjedhor.

PJESA III

Neni 10
Detyrat e anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së

1. Anëtarët e KQV-së përgjigjen për zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit, duke zbatuar detyrat e parashikuara në Kodin Zgjedhor, si dhe vendimet e udhëzimet e KQZ-së.

2. Sekretari i KQV-së zbaton të gjitha detyrat sipas përcaktimeve të nenit 47 të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimet e udhëzimet e KQZ-së.

Neni 11
Dokumenti i identifikimit

Gjatë ushtrimit të detyrës, anëtarët dhe sekretari i KQV-së janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

PJESA IV
MBLEDHJET E KQV-SË

Neni 12
Mbledhjet dhe vendimet KQV-së

1. Mbledhjet e KQV-së janë publike.

2. Mbledhjet e KQV-së janë të vlefshme, kur në to marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të KQV-së. Vendimet e KQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KQV-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.

3. Vendimet e KQV-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën **pro** ose **kundër**, si dhe arsyetimin përkatës.

4. KQV-ja merr vendime sipas përcaktimeve të nenit 48 pika 4 të Kodit Zgjedhor, duke përdorur modelet tip të vendimeve të miratuara nga KQZ-ja.

5. Të gjitha vendimet e KQV-së shënohen në librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

Neni 13

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

UDHËZIM
Nr.12, datë 15.12.2006

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEKLARIMIN E SHPENZIMEVE TË FUSHATËS ZGJEDHORE, TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2007

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 15.12.2006, me pjesëmarrjen e:

Çlirim Gjata	Kryetar
Flamur Çato	Zëvendëskryetar
Arben Ristani	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar
Fatmir Kumbaro	Anëtar
Klement Zguro	Anëtar

në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 144 dhe nenit 145/1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë procedurat për pranimin, regjistrimin, deklarimin dhe raportimin e dhuratave që marrin subjektet zgjedhore nga personat, fizikë dhe juridikë, privatë vendas për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2007.

Neni 2

Partitë politike, kandidatët e tyre, kandidatët e pavarur, si dhe koalicionet mund të përfitojnë për fushatën e tyre zgjedhore dhurata nga persona fizikë ose juridikë, privatë vendas.

Neni 3

Partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje, kandidatët e tyre, si dhe koalicionet zgjedhore janë të detyruar të regjistrojnë dhe të deklarojnë sipas formularëve tip bashkëlidhur këtij udhëzimi çdo dhuratë apo fonde të tjera jo shtetërore të përfituara për fushatën zgjedhore.

Neni 4

1. Dhuratat të cilat mund t'u jepen subjekteve zgjedhore ndahen në tre lloje:
- Dhurata në vlerë monetare;
- Dhurata në shërbime;
- Dhurata në sende.

2. Asnjë dhurues nuk mund t'i japë të njëjtit subjekt zgjedhor dhurata në vlerë më të madhe se 1 milion lekë, ose kundërvleftën në sende apo shërbime.

Neni 5

Subjekti zgjedhor, të cilit i ofrohen dhurata në vlera monetare, sende ose shërbime, sigurohet

paraprakisht për identitetin e dhuruesit dhe pasi e pranon dhuratën, e regjistron atë duke e përshkruar në mënyrë të saktë dhe të plotë.

Neni 6

Subjekti zgjedhor, për çdo dhuratë me vlerë më të madhe së 100 000 lekë ose kundërvleftën e kësaj shume në sende ose shërbime, të marrë në periudhën nga data e daljes së dekretit të Presidentit deri në datën e zgjedhjeve, duhet të deklarojë identitetin e dhuruesit dhe shumën e dhuruar, sipas formularit model 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 7

Për çdo dhuratë në sende ose shërbime, subjekti zgjedhor do të llogarisë dhe deklarojë kundërvleftën në lekë të sendeve ose shërbimeve duke u bazuar në indeksin mujor të çmimeve, të publikuar nga INSTAT-i. Për sendet ose shërbimet, vlera e të cilave nuk pasqyrohet në indeksin mujor të çmimeve, partitë politike dhe kandidatët e pavarur do t'i referohen çmimit të tregut në momentin e marrjes së dhuratës.

Neni 8

Për secilën prej dhuratave, pas vlerës në lekë do të shënohet:
a) shkronja M (për dhuratat në mjete monetare);
b) shkronja S (për dhuratat në sende);
c) shkronja SH (për dhuratat në shërbime).

Neni 9

Subjekti zgjedhor do të regjistrojë dhe deklarojë në formularin model 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi, të gjitha shpenzimet që do të kryejë në periudhën nga data e daljes së dekretit të Presidentit deri në datën e zgjedhjeve.

Neni 10

Partitë politike u kërkojnë kandidatëve të tyre që t'u dërgojnë të plotësuar formularët model 1 dhe 2, ku pasqyrohen të gjitha dhuratat dhe shpenzimet e kryera në periudhën nga data e daljes së dekretit të Presidentit deri në datën e zgjedhjeve.

Neni 11

Partitë politike i përfshijnë këto të dhëna në formularët model 1 dhe model 2, në të cilët ato kanë regjistruar dhe deklaruar dhuratat e përfituara prej tyre dhe i dorëzojnë në KQZ jo më vonë se 45 ditë pas datës së zgjedhjeve.

Neni 12

Çdo faqe e formularëve model 1 dhe 2 pas plotësimit do të vuloset dhe nënshkruhet prej kryetarit të partisë ose, sipas rastit, do të nënshkruhet prej kandidatit të pavarur.

Neni 13

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Model 1

TABELA E DHURATAVE TË PËRFITUARA NGA PARTIA/KOALICIONI _____PREJ PERSONAVE, FIZIKË OSE JURIDIKË, PRIVATË VENDAS, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE 2007

R.	PËRSHKRIMI I DHURIMIT	VLERA NE LEK	SUBJEKTI TË CILIT I ËSHTË BËRË DHURATA (NËSE ËSHTË I NDRYSHËM NGA PARTIA)	IDENTITETI I PLOTË I DHURUESIT	DATA E DHURIMIT	NR. I LLOGARISË KU U DEPOZITUA DHURATA
0						
1						
2						
3						

SHUMA TOTALE E DHURUAR

Shifër (fjalë) lek

UDHËZIM
Nr.13, datë 19.12.2006

PËR CAKTIMIN DHE PËRGATITJEN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, DHE MËNYRËN E NGRITJES SË GRUPEVE TË NUMËRIMIT

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 95, nenit 95/1, nenit 95/2, nenit 109/3, nenit 109/4, nenit 109/5 dhe nenit 109/6 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për caktimin e vendndodhjes së vendit të numërimit të votave (VNV), përgatitjen e tyre, si dhe të rregullojë mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të grupeve të numërimit (GN).

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 2

1. KZQV-ja organizon dhe përgatit vendin e numërimit të votave.
2. Vendndodhja e VNV-së caktohet me vendim të KQZ-së, mbi bazën e propozimit të paraqitur nga komisioni i zgjedhjeve për qeverisjen vendore.
3. Grupi i numërimit është përgjegjës për numërimin dhe vlerësimin e votave, si dhe për plotësimin e tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi.
4. Grupet e numërimit ngrihen me vendim të KZQV-së. Propozimet për anëtarët e GN-së bëhen nga partitë politike, që kanë propozuar anëtarët e KZQV-ve. Anëtarët e GN-së caktohen nga KZQV-ja, sipas modelit tip të vendimit të miratuar nga KQZ-ja.

Neni 3

1. Vendi i numërimit të votave caktohet si rregull në ndërtesa publike si: pallat sporti, pallat kulture, qendër kulturore e fëmijëve, palestra sportive, salla kinemaje, ambiente shkollash etj.
2. Vendi i numërimit të votave mund të caktohet në ndërtesa private vetëm me vendim të veçantë të KQZ-së.

PJESA II
CAKTIMI I VENDNDODHJES SË VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE (VNV)

Neni 4
Vendndodhja e VNV-së

1. Vendndodhja e VNV-së caktohet me vendim të KQZ-së, mbi bazën e propozimit të paraqitur nga komisioni i zgjedhjeve për qeverisjen vendore përkatëse, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.
2. Vendndodhja e vendit të numërimit të votave si rregull caktohet sa më afër vendit, ku është ngritur zyra e KZQV-së.

3. Vendndodhja e VNV-ve të njësive bashkiake të Tiranës duhet të jetë brenda territorit administrativ të këtyre njësive.

Neni 5
Kritere teknike të VNV-së

1. Vendi i numërimit të votave, i përzgjedhur nga komisioni i zgjedhjeve për qeverisjen vendore, duhet të plotësojë të paktën kriteret e mëposhtme teknike:

a) Për njësitë zgjedhore të cilat kanë në përbërje të tyre mbi 20 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 200 m^2.

b) Për njësitë zgjedhore të cilat kanë në përbërje të tyre 15 deri 20 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 100 m^2.

c) Për njësitë zgjedhore të cilat kanë në përbërje të tyre deri në 15 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 50 m^2.

d) Të ketë sistem të siguruar ndriçimi, të mjaftueshëm dhe të pandërprerë si në mjediset e brendshme, ashtu edhe përreth godinës.

e) Për aq sa është e mundur, të ketë më shumë se një derë komunikuese me mjedisin e jashtëm.

f) Të jetë e pajisur me mjete të mbrojtjes kundër zjarrit, si dhe të ndihmës së shpejtë.

2. Propozimi duhet të shoqërohet me skicën përkatëse të ambientit.

Neni 6
Organizimi i vendit të numërimit të votave

1. KZQV-ja organizon dhe përgatit VNV, në mënyrë të tillë që të garantojë zhvillimin normal të punës për numërimin e votave.

2. KZQV-ja organizon hapësirën e VNV në mënyrë të tillë, që të jetë e ndarë në mënyrë të qartë nga hapësira për vëzhguesit, kandidatët dhe mediat, por në çdo rast pa cenuar mundësinë e ndjekjes nga afër të procesit të numërimit.

3. Organizimi fizik i hapësirës në dispozicion të çdo GN-je, duhet të bëhet në mënyrë të tillë, që të pengojë ndërhyrjen e personave të tjerë të pranishëm në VNV.

4. Në çdo rast, KZQV-ja në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, jo më vonë se pesë ditë para ditës së zgjedhjeve, bën rregullimin e VNV sipas planvendosjes orientuese bashkëlidhur këtij udhëzimi, si edhe vendos pajisjet logjistike të nevojshme për kryerjen e procesit të numërimit, si më poshtë:

a) tavolina pune dhe 8 karrige për KZQV-në;

b) dyshe tavolinash (vendosen në formë T-je sipas shpjegimit në skemën orientuese) me nga tetë karrige për çdo grup të numërimit të votave;

c) strukturën ndarëse të hapësirës për publikun me hapësirën për numërimin e votave;

ç) tabelat treguese të dërguara nga KQZ-ja;

d) tabelat treguese për drejtimin e lëvizjes në mjediset e brendshme të VNV.

PJESA III
NGRITJA E GRUPEVE TË NUMËRIMIT

Neni 7
Caktimi i numrit të grupeve të numërimit

1. Çdo KZQV cakton me vendim ngritjen e grupeve të numërimit.

2. Në njësitë zgjedhore të cilat kanë deri në 5 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e një grupi numërimi.

3. Në njësitë zgjedhore të cilat kanë nga 6 deri në 10 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dy Grupeve Numërimi.

4. Në njësitë zgjedhore të cilat kanë nga 11 deri në 15 Qendra Votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tri grupeve numërimi.

5. Në njësitë zgjedhore të cilat kanë nga 16 deri në 20 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e katër grupeve numërimi.

6. Në njësitë zgjedhore të cilat kanë mbi 20 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e pesë grupeve numërimi.

7. Çdo grup numërimi përbëhet nga shtatë anëtarë dhe sekretari.

Neni 8

Emërimi i anëtarëve të grupeve të numërimit

1. Jo më vonë se 5 ditë përpara datës së zgjedhjeve, KZQV-ja merr vendim për numrin e GN që do të ngrejë. KZQV-ja u dërgon menjëherë këtë vendim partive politike, që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të grupeve të numërimit.

2. Propozimi për emrat e anëtarëve të GN i paraqitet KZQV-së nga personi i autorizuar nga kryetari i partisë, që ka të drejtë të bëjë propozimin.

3. Partia politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZQV-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për dy anëtarë të grupit të parë të numërimit, njëri prej të cilëve caktohet nga KZQV-ja, kryetar i këtij grupi numërimi.

4. Partia politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZQV-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për dy anëtarë të grupit të dytë të numërimit, njëri prej të cilëve caktohet nga KZQV-ja, kryetar i këtij grupi numërimi. Me këtë radhë vazhdohet me grupet e tjera të numërimit.

Neni 9

Partitë politike duhet te paraqesin edhe një listë rezervë me anëtarë të grupeve të numërimit, në rastet kur anëtarët e GN-ve duhet të zëvendësohen, për shkak të lodhjes fizike apo për shkaqe të tjera.

Neni 10

Zëvendësimi i anëtarëve të grupit të numërimit

1. Në rast se një parti politike nuk paraqet propozim brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 95/2 pika 1 të Kodit Zgjedhor, KZQV-ja me vendim cakton anëtarin zëvendësues.

2. Zëvendësuesi caktohet me short ndërmjet anëtarëve të KQV-ve të njësisë zgjedhore përkatëse, të emëruar me propozim të së njëjtës parti politike.

3. Procedura e shortit është si më poshtë:

a) Sekretari i KZQV-së përgatit dhe vendos në një enë një numër të barabartë shiritash letre me numrin e qendrave të votimit në njësinë e qeverisjes vendore. Secili nga shiritat e letrës ka të shënuar numrin e një qendre votimi.

b) Kryetari i KZQV-së tërheq njërin nga shiritat e letrës dhe lexon numrin e qendrës së votimit të shënuar në të.

c) Anëtari i kësaj KQV-je, i emëruar me propozim të partisë politike për të cilën hidhet shorti, caktohet anëtar i grupit të numërimit.

d) Kryetari i KZQV-së tërheq shirita letre në numër të barabartë me numrin e grupeve të numërimit që do të ngrihen.

e) Në rastet kur shorti hidhet si pasojë e mosparaqitjes së propozimeve nga një parti politike, e cila ka paraqitur propozime për emërimin e dy anëtarëve të KQV-së, atëherë pas çdo tërheqje shiriti letre me numrin e QV-së, kryetari i KZQV-së hedh short me monedhë, për të caktuar se cili nga dy anëtarët e KQV-së do të caktohet në grupin e numërimit. Procedura vazhdon e njëjtë derisa të plotësohen vendet e mbetura bosh.

4. Në rastet kur vendi i një anëtari të Grupit të Numërimit mbetet vakant gjatë procesit të numërimit të votave, partia politike e cila kishte propozuar anëtarin paraqet menjëherë propozimin e ri.

5. Nëse partia politike nuk paraqet propozimin për plotësimin e vendit të mbetur bosh brenda

1 ore, KZQV-ja zbaton procedurën e shortit sipas pikës 3 të këtij neni.

PJESA IV
GRUPI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

Neni 11
Kryetari dhe zv.kryetari i Grupit të Numërimit

1. Kryetari i GN është përgjegjës për drejtimin e proçedurave për numërimin dhe vlerësimin e votave, si dhe për hartimin e tabelave të rezultateve të qëndrës së votimit.

2. Kryetar i Grupit të Numërimit me numër tek, caktohet personi i propozuar nga Partia politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZQV-së.

3. Kryetar i Grupit të Numërimit me numër çift caktohet personi i propozuar nga partia politike, e cila ka propozuar Kryetarin e KZQV-së. Me këtë radhë vazhdohet me grupet e tjera.

4. Zëvendëskryetari i Grupit të Numërimit i përket partisë politike më të madhe të spektrit të kundërt me kryetarin.

Neni 12
Sekretari i grupit të numërimit

Sekretari i GN-së caktohet nga KZQV-ja me propozim të subjektit politik që ka paraqitur edhe propozimin për caktimin e zëvendëskryetarit të të njëjtit GN.

Neni 13

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



SHPJEGIME MBI PLANVENDOSJEN ORIENTUESE TË VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

1. Kjo planvendosje do t'u vijë në ndihmë për organizimin e brendshëm të vendit të numërimit të votave.

2. Pavarësisht se sa grupe numërimi do të ngrini, për aq sa është e mundur, mundohuni që organizimi i brendshëm i VNV-së të bëhet sipas kësaj planvendosjeje.

3. Ndani fillimisht hapësirën brenda të cilës do të zhvillohet procesi i numërimit, duke vendosur panelet ndarëse të dërguara nga KQZ-ja.

4. Brenda kësaj hapësire, përcaktoni vendin ku do të vendoset tavolina e punës së KZQV-së, vendi ku do të vendosen kutitë e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore para numërimit dhe pas numërimit, sipas kësaj ideje:

- Tavolina e KZQV-së vendoset në mes. Në të majtë të saj vendosen kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit para numërimit dhe në të djathtë të saj kutitë e votimit dhe ajo e materialeve zgjedhore pas numërimit.

- Vendosni kutitë në pozicion vertikal, në mënyrë që në fillim të jetë kutia e votimit për këshillin, pastaj kutia e votimit për kandidatët dhe në krye kutia e materialeve zgjedhore.

- Brenda kësaj hapësire mendoni për një vend ku do të vendosni kutitë e vlerësuara të parregullta gjatë procesit të marrjes në dorëzim nga KQV-të.

- Tregoni kujdes që kutitë e votimit dhe ajo e materialeve zgjedhore të jenë të ruajtura dhe të mos preken nga persona të paautorizuar.

5. Tavolina e çdo grupi numërimi vendoset në formë T-je: në pjesën vertikale (gjatësore) vendosen dy tavolina bashkë me qëllim që gjerësia e suprinës të jetë e mjaftueshme dhe fletët e votimit të mos bien në tokë, ndërsa në pjesën horizontale vendoset vetëm një tavolinë.

6. Anëtarët e GN-së ulen sipas mënyrës që paraqitet në planvendosjen orientuese.

7. Përcaktoni vendin ku do të vendosen vëzhguesit dhe media.

8. Largësia nga tavolina e punës së GN-së dhe vëzhguesve (e ndarë me panelet ndarëse) duhet të jetë e tillë që të mundësojë vëzhgimin normal të procesit të numërimit, por duke shmangur kontaktin fizik midis vëzhguesve dhe anëtarëve të GN-së.

9. Tregoni kujdes që në VNV të mos ketë persona të tjerë të paautorizuar nga KZQV-ja.

10. Përcaktoni mënyrën e lëvizjes brenda hapësirës ku kryhet numërimi, më qëllim që çdo procedurë të kryhet me rregull dhe pa rrëmujë.

11. Siguroni që procesi i numërimit të kryhet me qetësi dhe me rregull.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare
ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark",
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	**PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)…….....**	**1500**
2.	**PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) …….....**	**600**
3.	**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....**	**1300**
4.	**PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT…….....**	**500**

Botime të reja

1	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…....….....**	**1000**
2	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…....….....**	**500**
3	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)……..….....**	**1000**
4	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)……..….....**	**500**
5	**PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË…….....**	**1000**
6	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR…….**	**800**
7	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET……....….....**	**500**
8	**PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)……**	**1000**
9	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE…….....**	**500**

Hyri në shtyp më 27.12.2006
Doli nga shtypi më 29.12.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë